



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2025 – Numri: 54

Tiranë – E mërkurë, 19 mars 2025

PËRMBAJTJA

	Faqe
Urdhër i ministrit të Brendshëm nr. 51, datë 18.3.2025	Për delegimin e kompetencave..... 6299
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 219, datë 6.3.2025	Për disa shtesa dhe ndryshime në urdhrin e ministrit nr. 113, datë 15.3.2022, “Për miratimin e rregullores për masat mbrojtëse kundër dëmtuesve të bimëve”, të ndryshuar..... 6299
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 240, datë 9.3.2025	Për marrjen e masave kufizuese për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjes së influencës aviare në shpendë, në mjediset e hapura dhe në tregjet e kafshëve të gjalla..... 6308
Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut datë 25.2.2025	Çështja Gëllçi kundër Shqipërisë (<i>kërkesa nr. 15468/23</i>) 6309
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 6, datë 10.2.2025	Me objekt shfuqizimin e ligjit nr. 69/2023, datë 21.7.2023, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 53/2019, datë 18.7.2019 ‘Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë’”, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë..... 6312
Urdhër i drejtorit të përgjithshëm të Arkivave nr. 207, datë 12.3.2025	Për ngarkim të përkohshëm në detyrë (zëvendësim)..... 6325
	Bibliografia e informacionit të deklasifikuar “Sekret shtetëror” në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave..... 6325
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 6/9, datë 11.3.2025	Për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit, “‘Auto-Moto Park’, me vendndodhje Bashkia Elbasan”..... 6330
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 228/7, datë 11.3.2025	Për shpronësim, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Spostim i linjave 220 kV Fier–Rrashbull, si rrjedhojë e ndërtimit të segmentit të rrugës Thumanë–Kashar”..... 6332

Kërkesë e Agjencisë Shtetërore
për Shpronësimin nr. 230/7,
datë 11.3.2025

Për disa shtesa dhe ndryshime të VKM-së nr. 20, datë 17.1.2024,
“Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të
paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit
‘Lidhja e Rrugës Transballkanike me Portin Detar, Vlorë’”.....

6336

Korrigjim gabimi material në udhëzimin e Ministrisë së Arsimit dhe
Sportit nr. 2, datë 21.1.2025, “Për disa shtesa dhe ndryshime në
udhëzimin nr. 1, datë 14.1.2020, ‘Për dokumentacionin dhe
procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të
arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të
studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të
lartë’”, i ndryshuar, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 19, datë 3.2.2025..

6339



URDHËR
Nr. 51, datë 18.3.2025

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, të pikës 2 të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave drejtorit të përgjithshëm të Zhvillimit për Migracionin dhe Azilin znj. Silvana Banushi, të praktikave të mëposhtme:

a) Nënshkrimin e kërkesave drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, drejtorive vendore të policisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile për shtetasit që aplikojnë për fitimin, rifitimin e shtetësisë shqiptare dhe për shtetasit që kërkojnë heqjen dorë nga shtetësia shqiptare.

b) Kthimi i aplikimit të paraqitur në rastet e mungesës ose të pasaktësisë së dokumentacionit për shtetasit që aplikojnë për fitimin, rifitimin e shtetësisë shqiptare dhe për shtetasit që kërkojnë heqjen dorë nga shtetësia shqiptare.

c) Trajtimin dhe nënshkrimin e kërkesave të ndryshme nga persona fizikë dhe juridikë, shtetas shqiptarë dhe/ose të huaj, për çështjet që lidhen me shtetësinë shqiptare.

2. Delegimin e vulës, drejtorit të përgjithshëm të Zhvillimit për Migracionin dhe Azilin për praktikën e përcaktuara në pikën 1 të këtij urdhri.

3. Kompetencat sipas përcaktimit të pikës 1 të këtij urdhri do të ushtrohen nga data 13.3.2025 deri në shfuqizimin e këtij urdhri.

4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet drejtori i përgjithshëm i Zhvillimit për Migracionin dhe Azilin.

5. Me njohjen dhe zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Drejtoria e Politikave të Shtetësisë dhe Sektori i Arkiv-Protokollit.

6. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për sigurimin e zbatimit dhe kontrollin e zbatimit të këtij urdhri.

7. Urdhri nr. 238, datë 27.5.2021, “Për delegimin e kompetencave”, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Ervin Hoxha

URDHËR
Nr. 219, datë 6.3.2025

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË URDHRIN E MINISTRIT NR. 113,
DATË 15.3.2022, “PËR MIRATIMIN E
RREGULLORES PËR MASAT
MBROJTËSE KUNDËR DËMTUESVE
TË BIMËVE”, TË NDRYSHUAR**

Në zbatim të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, në pikën 3, të nenit 14, të ligjit nr. 105/2016, “Për mbrojtjen e bimëve”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

Në rregulloren “Për masat mbrojtëse kundër dëmtuesve të bimëve”, miratuar me urdhrin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 113, datë 15.3.2022, “Për miratimin e rregullores për masat mbrojtëse kundër dëmtuesve të bimëve”, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshime si vijon:

1. Aneksi II zëvendësohet me aneksin, bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Referencat e dhëna në nenet 2 deri në 22 për anekset me numrat 1, 2, 3, 4, 5, 7, 8, 9, 10, 12, 13, 14, 15, 16 të zëvendësohen respektivisht me numrat I, II, III, IV, V, VII, VIII, IX, X, XII, XIII, XIV, XV, XVI.

3. Në pikën 2, të nenit 11, të kreut V, togfjalëshi “në aneksin 9” zëvendësohet me togfjalëshin “në aneksin XI”.

4. Në nenin 15, të kreut VI, fjalia “Certifikata fitosanitare e brendshme lëshohet nga AKVMB-ja për bimët e destinuar për mbjellje”, ndryshohet me formulimin si vijon:

“Certifikata fitosanitare e brendshme lëshohet nga AKVMB-ja për bimët e destinuar për mbjellje, që janë në proces certifikimi zyrtar, sipas ligjit nr. 10416, datë 7.4.2011, “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”, të ndryshuar, si dhe për bimët, produktet bimore dhe objektet e tjera të listuar në



aneksin XI të kësaj rregulloreje deri në zëvendësimin dhe implementimin e pasaportës bimë.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.

6. Ky urdhër hyn në fuqi 15 ditë nga botimi në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

“ANEKSI II

LISTA E DËMTUESVE KARANTINORË TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KODET E TYRE PÛRKATËSE

Përmbajtja

Pjesa A: Dëmtuesit që nuk dihet të jenë hasur në territorin e Republikës së Shqipërisë

1. Bakteret;
2. Kërpudhat dhe oomicetet;
3. Insektet dhe merimangat;
4. Molusqet;
5. Nematodat;
6. Bimë parazitare;
7. Viruset, viroidet dhe fitoplazmat.

Pjesa B: Dëmtuesit që dihet të jenë hasur në territorin e Republikës së Shqipërisë

1. Kërpudhat dhe oomicetet;
2. Insektet dhe merimangat;
3. Nematodat;
4. Viruset, viroidet dhe fitoplazmat.

PJESA A

DËMTUESIT QË NUK DIHET TË JENË HASUR NË TERRITORIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Nr.	Dëmtuesit karantinorë dhe kodet e tyre të caktuara nga EPPO-ja
1. Bakteret	
1.	<i>Candidatus Liberibacter africanus</i> [LIBEAF]
2.	<i>Candidatus Liberibacter americanus</i> [LIBEAM]
3.	<i>Candidatus Liberibacter asiaticus</i> [LIBEAS]
4.	<i>Clavibacter sepedonicus</i> (Spieckermann dhe Kottho) Nouioui <i>et al.</i> [CORBSE]
5.	<i>Curtobacterium flaccumfaciens</i> pv. <i>flaccumfaciens</i> (Hedges) Collins dhe Jones [CORBFL]
6.	<i>Pantoea stewartii</i> subsp. <i>stewartii</i> (Smith) Mergaert, Verdonck & Kersters [ERWIST]
7.	<i>Ralstonia pseudosolanacearum</i> Safni <i>et al.</i> [RALSPS]
8.	<i>Ralstonia solanacearum</i> (Smith) Yabuuchi <i>et al.</i> emend. Safni <i>et al.</i> [RALSSL]
9.	<i>Ralstonia syzygii</i> subsp. <i>celebesensis</i> Safni <i>et al.</i> [RALSSC]
10.	<i>Ralstonia syzygii</i> subsp. <i>indonesiensis</i> Safni <i>et al.</i> [RALSSI]
11.	<i>Xanthomonas oryzae</i> pv. <i>oryzae</i> (Ishiyama) Swings <i>et al.</i> [XANTOR]
12.	<i>Xanthomonas oryzae</i> pv. <i>oryzicola</i> (Fang <i>et al.</i>) Swings <i>et al.</i> [XANTTO]
13.	<i>Xanthomonas citri</i> pv. <i>aurantifolia</i> (Schaad <i>et al.</i>) Constantin <i>et al.</i> [XANTAU]
14.	<i>Xanthomonas citri</i> pv. <i>citri</i> (Hasse) Constantin <i>et al.</i> [XANTCI]
15.	<i>Xylella fastidiosa</i> (Wells <i>et al.</i>) [XYLEFA]
2. Kërpudhat dhe oomicetet	
1.	<i>Anisogramma anomala</i> (Peck) E. Müller [CRSPAN]



2.	<i>Apiosporina morbosa</i> (Schwein.) Arx [DIBOMO]
3.	<i>Atropellis</i> spp. [1ATRPG]
4.	<i>Botryosphaeria kawatsukai</i> (Hara) G.Y. Sun dhe E. Tanaka [PHYOPI]
5.	<i>Bretziella jagacearum</i> (Bretz) Z.W. de Beer, T.A. Duong & M.J. Wingfield, comb. nov. [CERAFA]
6.	<i>Ceratocystis platani</i> (J. M. Walter) Engelbr. & T. C. Harr [CERAFP]
7.	<i>Chrysomyxa arctostaphyli</i> Dietel [CHMYAR]
8.	<i>Cronartium</i> spp. [1CRONG], përveç <i>Cronartium gentianum</i> , <i>Cronartium pini</i> (Willdenow) Jørstad [ENDCPI] dhe <i>Cronartium ribicola</i> Fischer [CRONRI].
9.	<i>Davidsoniella virescens</i> (R.W. Davidson) Z.W. de Beer, T.A. Duong & M.J. Wingfield [CERAVI]
10.	<i>Elsinoë australis</i> Bitanc. & Jenkins [ELSIAU]
11.	<i>Elsinoë citricola</i> X.L. Fan, R.W. Barreto & Crous [ELSICI]
12.	<i>Elsinoë fawcettii</i> Bitanc. & Jenkins [ELSIFA]
13.	<i>Fusarium circinatum</i> Nirenberg & O'Donnell [GIBBCI]
14.	<i>Fusarium oxysporum</i> f. sp. <i>albedinis</i> (Kill. & Maire) W.L. Gordon [FUSAAL]
15.	<i>Geosmithia morbida</i> Kolarik, Freeland, Utley & Tisserat [GEOHMO]
16.	<i>Gymnosporangium</i> spp. [1GYMNG], përveç: <i>Gymnosporangium amelantheris</i> E. Fisch. ex F. Kern, <i>Gymnosporangium atlanticum</i> Guyot & Malenc Bon, <i>Gymnosporangium clavariiforme</i> (Wulfen) DC [GYMNCF], <i>Gymnosporangium confusum</i> Plowr. [GYMNCO], <i>Gymnosporangium cornutum</i> Arthur ex F. Kern [GYMNCR], <i>Gymnosporangium fusisporum</i> E. Fisch., <i>Gymnosporangium gaeumannii</i> H. Zogg, <i>Gymnosporangium gracile</i> Pat., <i>Gymnosporangium minus</i> Crowell, <i>Gymnosporangium orientale</i> P. Syd. & Syd., <i>Gymnosporangium sabiniae</i> (Dicks.) G. Winter [GYMNFU], <i>Gymnosporangium torminali-juniperini</i> E. Fisch., <i>Gymnosporangium tremelloides</i> R. Hartig [GYMNTR]
17.	<i>Coniferiopsis sulphurascens</i> (Pilát) L.W. Zhou & Y.C. Dai [PHELSU]
18.	<i>Coniferiopsis weirii</i> (Murrill) L.W. Zhou & Y.C. Dai [INONWE]
19.	<i>Melampsora farlowii</i> (Arthur) Davis [MELMFA]
20.	<i>Mycodiella laricis-leptolepidis</i> (Kaz. Itô, K. Satô & M. Ota) Crous [MYCOLL]
21.	<i>Neocosmospora ambrosia</i> (Gadd & Loos) L. Lombard & Crous [FUSAAM]
22.	<i>Neocosmospora euwallaceae</i> (S. Freeman, Z. Mendel, T. Aoki & O'Donnell) Sandoval-Denis, L. Lombard & Crous [FUSAEW]
22.1.	<i>Neofusicoccum laricinum</i> (Sawada) Y. Hattori & C. Nakashima [GUIGLA]
23.	<i>Phyllosticta citricarpa</i> (McAlpine) Van der Aa [GUIGCI]
24.	<i>Phyllosticta solitaria</i> Ellis & Everhart [PHYSSL]
25.	<i>Phymatotrichopsis omnivora</i> (Duggar) Hennebert [PHMPOM]
26.	<i>Phytophthora ramorum</i> (izolime jo të BE-së) Werres, De Cock & Man in 't Veld [PHYTRA]
27.	<i>Pseudocercospora angolensis</i> (T. Carvalho & O. Mendes) Crous & U. Braun [CERCAN]
28.	<i>Pseudocercospora pini-densiflorae</i> (Hori & Nambu) Deighton [CERSPD]
29.	<i>Puccinia pittieriana</i> Hennings [PUCCPT]
30.	<i>Septoria malagutii</i> E.T. Cline [SEPTLM]
31.	<i>Sphaerulina musiva</i> (Peck) Quaedvl. Verkley & Crous. [MYCOPP]
32.	<i>Stagonosporopsis andigena</i> (Turkensteen) Aveskamp, Gruyter & Verkley [PHOMAN]
33.	<i>Stegophora ulmea</i> (Fr.) Syd. & P. Syd [GNOMUL]
34.	<i>Synchytrium endobioticum</i> (Schilb.) Percival [SYNCEN]
35.	<i>Thecaphora solani</i> Thirumalachar & O'Brien) Mordue [THPHSO]
36.	<i>Tilletia indica</i> Mitra [NEOVIN]
37.	<i>Venturia nashicola</i> S. Tanaka & S. Yamamoto [VENTNA]
3. Insektet dhe merimangat	
1.	<i>Acleris</i> spp.: 1.1. <i>Acleris gloverana</i> (Walsingham) [ACLRGL] 1.2. <i>Acleris issikii</i> Oku [ACLRIS] 1.3. <i>Acleris minuta</i> (Robinson) [ACLRMI] 1.4. <i>Acleris nishidai</i> Brown [ACLRNI] 1.5. <i>Acleris nivisellana</i> (Walsingham) [ACLRNV] 1.6. <i>Acleris robinsoniana</i> (Forbes) [ACLRRO] 1.7. <i>Acleris semipurpurana</i> (Kearfott) [CROISE] 1.8. <i>Acleris senescens</i> (Zeller) [ACLRSE] 1.9. <i>Acleris variana</i> (Fernald) [ACLRVA]
2.	<i>Acrobasis pyrivorella</i> (Matsumura) [NUMOPI]
3.	<i>Agrilus anxius</i> Gory [AGRLAX]



4.	<i>Agrilus planipennis</i> Fairmaire [AGRLPL]
5.	<i>Aleurocanthus citripedus</i> Quaintance & Baker [ALECCT]
6.	<i>Aleurocanthus spiniferus</i> (Quaintance) [ALECSN]
7.	<i>Aleurocanthus woglumi</i> Ashby [ALECWO]
8.	<i>Andean potato weevil</i> komplekse: 8.1 <i>Phyrdenus muriceus</i> Germar [PHRDMU] 8.2 <i>Premnotrypes</i> spp. [1PREMG] 8.3 <i>Rhigopsidius tucumanus</i> Heller [RHGPTU]
9.	<i>Anoplophora chinensis</i> (Thomson) [ANOLCN]
10.	<i>Anoplophora glabripennis</i> (Motschulsky) [ANOLGL]
11.	<i>Anthonomus bisignifer</i> Schenkling [ANTHBI]
12.	<i>Anthonomus eugenii</i> Cano [ANTHEU]
13.	<i>Anthonomus quadrigibbus</i> Say [TACYQU]
14.	<i>Anthonomus signatus</i> Say [ANTHSI]
15.	<i>Apriona cinerea</i> Chevrolat [APRICI]
16.	<i>Apriona germari</i> (Hope) [APRIGE]
17.	<i>Apriona rugicollis</i> Chevrolat [APRIJA]
18.	<i>Aromia bungii</i> (Faldermann) [AROMBU]
19.	<i>Arrhenodes minutus</i> Drury [ARRHMI]
20.	<i>Aschistonyx eppoi</i> Inouye [ASCXEP]
21.	<i>Bactericera cockerelli</i> (Sulc.) [PARZCO]
22.	<i>Bemisia tabaci</i> Genn. (popullata jo-europiane) i njohur si vektor i virusit [BEMITA]
23.	<i>Carposina sasakii</i> Matsumura [CARSSA]
24.	<i>Ceratotrhopoides claratris</i> (Shumsher) [CRTZCL]
25.	<i>Choristoneura</i> spp.: 25.1 <i>Choristoneura carnana</i> Barnes & Busck [CHONCA] 25.2 <i>Choristoneura conflictana</i> Walker [ARCHCO] 25.3 <i>Choristoneura fumiferana</i> Clemens [CHONFU] 25.4 <i>Choristoneura lambertiana</i> Busck [TORTLA] 25.5 <i>Choristoneura occidentalis biennis</i> Freeman [CHONBI] 25.6 <i>Choristoneura occidentalis occidentalis</i> Freeman [CHONOC] 25.7 <i>Choristoneura orae</i> Freeman [CHONOR] 25.8 <i>Choristoneura parallela</i> Robinson [CHONPA] 25.9 <i>Choristoneura pinus</i> Freeman [CHONPI] 25.10 <i>Choristoneura retiniana</i> Walsingham [CHONRE] 25.11 <i>Choristoneura rosaceana</i> Harris [CHONRO]
26.	<i>Cicadomorpha</i> , known to be vectors of <i>Xylella fastidiosa</i> (Wells et al.): 26.1. <i>Acrogonia citrina</i> Marucci [ACRGCI] 26.2. <i>Acrogonia virescens</i> (Metcalfe) [ACRGVI] 26.3. <i>Aphrophora angulata</i> Ball [APHRAN] 26.4. <i>Aphrophora permutata</i> Uhler [APHRPE] 26.5. <i>Bothrogonia ferruginea</i> (Fabricius) [TETTFE] 26.6. <i>Bucephalogonia xanthophis</i> (Berg) [BUCLXA] 26.7. <i>Clastoptera achatina</i> Germar [CLASAC] 26.8. <i>Clastoptera brunes</i> Ball [CLASBR] 26.9. <i>Cuerna costalis</i> (Fabricius) [CUERCO] 26.10. <i>Cuerna occidentalis</i> Osman dhe Beamer [CUEROC] 26.11. <i>Cyphonia clavigera</i> (Fabricius) [CYPACG] 26.12. <i>Debacona missionum</i> (Berg) [ONCMMI] 26.13. <i>Dilobopterus costalimai</i> Young [DLBPCO] 26.14. <i>Draeculacephala</i> sp. [DRAESP] 26.15. <i>Ferrariana trivittata</i> (Signoret) [FRRATR] 26.16. <i>Fingeriana dubia</i> Cavichioli [FINGDU] 26.17. <i>Friscanus friscanus</i> (Ball) [FRISFR] 26.18. <i>Graphocephala atropunctata</i> (Signoret) [GRCPAT] 26.19. <i>Graphocephala confluens</i> (Uhler) [GRCPCF] 26.20. <i>Graphocephala versuta</i> (Say) [GRCPVE] 26.21. <i>Helochara delta</i> Oman [HELHDE] 26.22. <i>Homalodisca ignorata</i> Melichar [HOMLIG]



26.23.	<i>Homalodisca insolita</i> Walker [HOMLIN]
26.24.	<i>Homalodisca vitripennis</i> (Germar) [HOMLTR]
26.25.	<i>Lepyronia quadrangularis</i> (Say) [LEPOQU]
26.26.	<i>Macgonalia cavifrons</i> (Stal) [MAGOCA]
26.27.	<i>Macgonalia leucomelas</i> (Walker) [MAGOLE]
26.28.	<i>Molomea consolidata</i> Schroder [MOLMCO]
26.29.	<i>Neokolla hieroglyphica</i> (Say) [GRCPHI]
26.30.	<i>Neokolla severini</i> DeLong [NKOLSE]
26.31.	<i>Oncometopia facialis</i> Signoret [ONCMFA]
26.32.	<i>Oncometopia nigricans</i> Walker [ONCMNI]
26.33.	<i>Oncometopia orbona</i> (Fabricius) [ONCMUN]
26.34.	<i>Oragua discoidula</i> Osborn [ORAGDI]
26.35.	<i>Pagaronia confusa</i> Oman [PGARCO]
26.36.	<i>Pagaronia furcata</i> Oman [PGARFU]
26.37.	<i>Pagaronia tredecimpunctata</i> Ball [PGARTR]
26.38.	<i>Pagaronia triunata</i> Ball [PGARTN]
26.39.	<i>Parathona gratiosa</i> (Blanchard) [PTHOGR]
26.40.	<i>Plesiommata corniculata</i> Young [PLSOCO]
26.41.	<i>Plesiommata mollicella</i> (Fowler) [PLSOMO]
26.42.	<i>Poophilus costalis</i> (Walker) [POOPCO]
26.43.	<i>Sibovia sagata</i> (Signoret) [SIBOSA]
26.44.	<i>Sonesimia grossa</i> (Signoret) [SONEGR]
26.45.	<i>Tapajosa rubromarginata</i> (Signoret) [TAPARU]
26.46.	<i>Xyphon flaviceps</i> (Riley) [CARNFL]
26.47.	<i>Xyphon fulgida</i> (Nottingham) [CARNFU]
26.48.	<i>Xyphon triguttata</i> (Nottingham) [CARNTR]
27.	<i>Conotrachelus nenuphar</i> (Herbst) [CONHNE]
28.	<i>Dendrolimus sibiricus</i> Chetverikov [DENDSI]
29.	<i>Diabrotica barberi</i> Smith dhe Lawrence [DIABLO]
30.	<i>Diabrotica undecimpunctata howardi</i> Barber [DIABUH]
31.	<i>Diabrotica undecimpunctata undecimpunctata</i> Mannerheim [DIABUN]
32.	<i>Diabrotica virgifera zea</i> Krysan & Smith [DIABVZ]
33.	<i>Eotetranychus lewisi</i> (McGregor) [EOTELE]
34.	<i>Euwallacea fornicatus</i> sensu lato [XYLBFO]
35.	<i>Exomala orientalis</i> (Waterhouse) [ANMLOR]
36.	<i>Grapholita inopinata</i> (Heinrich) [CYDIIN]
37.	<i>Grapholita packardii</i> Zeller [LASPPA]
38.	<i>Grapholita prunivora</i> (Walsh) [LASPPR]
39.	<i>Hishimonus phycitis</i> (Distant) [HISHPH]
40.	<i>Keiferia lycopersicella</i> (Walsingham) [GNORLY]
41.	<i>Listronotus bonariensis</i> (Kuschel) [HYROBO]
42.	<i>Lopholeucaspis japonica</i> Cockerell [LOPLJA]
43.	<i>Lycorma delicatula</i> (White) [LYCMDE]
44.	<i>Margarodidae</i> :
44.1.	<i>Dimargarodes meridionalis</i> Morrison [MARGME]
44.2.	<i>Eumargarodes laingi</i> Allsopp <i>et al.</i> [EUMGLA]
44.3.	<i>Eurbizococcus brasiliensis</i> Jakubski [EURHBR]
44.4.	<i>Eurbizococcus colombianus</i> Jakubski [EURHCO]
44.5.	<i>Margarodes capensis</i> Giard [MARGCA]
44.6.	<i>Margarodes greeni</i> Brain [MARGGR]
44.7.	<i>Margarodes prieskaensis</i> (Jakubski) [MARGPR]
44.8.	<i>Margarodes trimeni</i> Brain [MARGTR]
44.9.	<i>Margarodes vitis</i> Reed [MARGVI]
44.10.	<i>Margarodes vredendalensis</i> de Klerk [MARGVR]
44.11.	<i>Porphyrophora tritici</i> Sarkisov <i>et al.</i> [PORPTR]
45.	<i>Massicus raddei</i> (Blessig) [MALLRA]
46.	<i>Monochamus</i> spp. (popullata jo-europiane) [1MONCG]
47.	<i>Myndus crudus</i> van Duzee [MYNDCR]
48.	<i>Naupactus leucoloma</i> Boheman [GRAGLE]



49.	<i>Nemorimyza maculosa</i> (Malloch) [AMAZMA]
50.	<i>Neoleucinodes elegantalis</i> (Guenée) [NEOLEL]
51.	<i>Oemona birta</i> (Fabricius) [OEMOHI]
52.	<i>Oligonychus perditus</i> Pritchard dhe Baker [OLIGPD]
53.	<i>Phylloctes fructiphilus</i> (Germar) [PHYCFR]
54.	<i>Pissodes cibriani</i> O'Brien [PISOCI]
55.	<i>Pissodes fasciatus</i> Leconte [PISOFA]
56.	<i>Pissodes nemorensis</i> Germar [PISONE]
57.	<i>Pissodes nitidus</i> Roelofs [PISONI]
58.	<i>Pissodes punctatus</i> Langor & Zhang [PISOPU]
59.	<i>Pissodes strobi</i> (Peck) [PISOST]
60.	<i>Pissodes terminalis</i> Hopping [PISOTE]
61.	<i>Pissodes yunnanensis</i> Langor & Zhang [PISOYU]
62.	<i>Pissodes zitacnarensis</i> Sleeper [PISOZI]
63.	<i>Pityophthorus juglandis</i> Blackman [PITOJU]
64.	<i>Polygraphus proximus</i> Blandford [POLGPR]
65.	<i>Popillia japonica</i> Newman [POPIJA]
66.	<i>Prodiplosis longifila</i> Gagné [PRDILO]
67.	<i>Pseudopityophthorus minutissimus</i> (Zimmermann) [PSDPMI]
68.	<i>Pseudopityophthorus pruinosus</i> (Eichhoff) [PSDPPR]
69.	<i>Rhynchophorus palmarum</i> (L.) [RHYCPA]
70.	<i>Saperda candida</i> Fabricius [SAPECN]
71.	<i>Scirtotrips aurantii</i> Faure [SCITAU]
72.	<i>Scirtotrips citri</i> (Moulton) [SCITCI]
73.	<i>Scirtotrips dorsalis</i> Hood [SCITDO]
74.	<i>Scolytidae</i> spp. (Jo-europiane) [1SCOLF]
75.	<i>Spodoptera eridania</i> (Cramer) [PRODER]
76.	<i>Spodoptera frugiperda</i> (Smith) [LAPHFR]
77.	<i>Spodoptera litura</i> (Fabricius) [PRODLI]
78.	<i>Tecia solanivora</i> (Povolný) [TECASO]
79.	<i>Tephritidae</i>: 79.1 <i>Acidiella kagoshimensis</i> (Miyake) [ACIEKA] 79.2 <i>Acidoxantha bombacis</i> de Meijere [ACIXBO] 79.3 <i>Acroceratitis distincta</i> (Zia) [ACRSDI] 79.4 <i>Adrama</i> spp. [1ADRAG] 79.5 <i>Anastrepha</i> spp. [1ANSTG] 79.6 <i>Anastrepha ludens</i> (Loew) [ANSTLU] 79.7 <i>Asimoneura pantomelas</i> (Bezzi) [ASIMPA] 79.8 <i>Austrotephritis protrusa</i> (Hardy & Drew) [AUSHPR] 79.9 <i>Bactrocera</i> spp. [1BCTRG], përveç <i>Bactrocera oleae</i> (Gmelin) [DACUOL] 79.10 <i>Bactrocera dorsalis</i> (Hendel) [DACUDO] 79.11 <i>Bactrocera latifrons</i> (Hendel) [DACULA] 79.12 <i>Bactrocera zonata</i> (Saunders) [DACUZO] 79.13 <i>Bistrispinaria fortis</i> (Speiser) [BISRFO] 79.14 <i>Bistrispinaria magniceps</i> (Bezzi) [BISRMA] 79.15 <i>Callistomyia flavilabris</i> Hering [CLMYFL] 79.16 <i>Campiglossa albiceps</i> (Loew) [CAMGAL] 79.17 <i>Campiglossa californica</i> (Novak) [CAMGCA] 79.18 <i>Campiglossa duplex</i> (Becker) [CAMGDU] 79.19 <i>Campiglossa reticulata</i> (Becker) [CAMGRE] 79.20 <i>Campiglossa snowi</i> (Hering) [CAMGSN] 79.21 <i>Carpomya incompleta</i> (Becker) [CARYIN] 79.22 <i>Carpomya pardalina</i> (Bigot) [CARYPA] 79.23 <i>Ceratitidis</i> spp. [1CERTG], përveç <i>Ceratitidis capitata</i> (Wiedemann) [CERTCA] 79.24 <i>Craspedoxantha marginalis</i> (Wiedemann) [CRSXMA] 79.25 <i>Dacus</i> spp. [1DACUG] 79.26 <i>Dioxyna chilensis</i> (Macquart) [DIOXCH] 79.27 <i>Dirioxa pornia</i> (Walker) [TRYEMU] 79.28 <i>Euleia separata</i> (Becker) [EULISE]



	79.29 <i>Euphranta camelliae</i> (Ito) [EPHNCA] 79.30 <i>Euphranta canadensis</i> (Loew) [EPOCCA] 79.31 <i>Euphranta cassiae</i> (Munro) [RHACCA] 79.32 <i>Euphranta japonica</i> (Ito) [RHACJA] 79.33 <i>Euphranta oshimensis</i> (Shiraki) [EPHNOS] 79.34 <i>Eurosta solidaginis</i> (Fitch) [EUOSSO] 79.35 <i>Eutreta</i> spp. [1EUTTG] 79.36 <i>Gastrozona nigrifemur</i> David & Hancock [GASZNI] 79.37 <i>Goedenia stenoparia</i> (Steyskal) [GOEDST] 79.38 <i>Gymnocarena</i> spp. [GYMRSP] 79.39 <i>Insizwa oblita</i> (Munro) [INZWOB] 79.40 <i>Marriottella exquisita</i> Munro [MARREX] 79.41 <i>Monacrostichus citricola</i> Bezzi [MNAHCI] 79.42 <i>Neaspilota alba</i> (Loew) [NEAIAL] 79.43 <i>Neaspilota reticulata</i> Norrbom & Foote [NEAIRE] 79.44 <i>Neoceratitis asiatica</i> (Becker) [NCERAS] 79.45 <i>Neoceratitis cyanescens</i> (Bezzi) [CERTCY] 79.46 <i>Neotephritis finalis</i> (Loew) [NTPRFI] 79.47 <i>Paracantha trinotata</i> (Foote) [PCANTR] 79.48 <i>Parastenopa limata</i> (Coquillett) [PSTELI] 79.49 <i>Paratephritis fukuii</i> Shiraki [PTEPFU] 79.50 <i>Paratephritis takeuchii</i> Ito [PTEPTA] 79.51 <i>Paraterellia varipennis</i> (Coquillett) [PTLLVA] 79.52 <i>Philophylla fossata</i> (Fabricius) [PHIPFO] 79.53 <i>Procecidochares</i> spp. [1PROIG] 79.54 <i>Ptilona confinis</i> (Walker) [PTIOCO] 79.55 <i>Ptilona persimilis</i> Hendel [PTIOPE] 79.56 <i>Rhagoletis</i> spp. [1RHAGG], përveç <i>Rhagoletis alternata</i> (Fallén) [RHAGAL], <i>Rhagoletis batava</i> Hering [RHAGBA], <i>Rhagoletis berberidis</i> Jermy [RHAGBE], <i>Rhagoletis cerasi</i> L. [RHAGCE], <i>Rhagoletis cingulata</i> (Loew) [RHAGCI], <i>Rhagoletis completa</i> Cresson [RHAGCO], <i>Rhagoletis meigenii</i> (Loew) [CERTME], <i>Rhagoletis suavis</i> (Loew) [RHAGSU], <i>Rhagoletis zernyi</i> Hendel [RHAGZR] 79.57 <i>Rioxoptilona dunlopi</i> (Wulp) [ACNVDU] 79.58 <i>Sphaeniscus binoculatus</i> (Bezzi) [SFANBI] 79.59 <i>Sphenella nigricornis</i> Bezzi [SFENNI] 79.60 <i>Strauszia</i> spp. [1STRAG], përveç <i>Strauszia longipennis</i> (Wiedemann) [STRALO] 79.61 <i>Taomyia marshalli</i> Bezzi [TAOMMA] 79.62 <i>Tephritis leavittensis</i> Blanc [TEPRLE] 79.63 <i>Tephritis luteipes</i> Merz [TEPRLU] 79.64 <i>Tephritis ovatipennis</i> Foote [TEPROV] 79.65 <i>Tephritis pura</i> (Loew) [TEPRPU] 79.66 <i>Toxotrypana curvicauda</i> Gerstaecker [TOXTCU] 79.67 <i>Toxotrypana recurcauda</i> Tigrero [ANSTRE] 79.68 <i>Trupanea bisetosa</i> (Coquillett) [TRUPBI] 79.69 <i>Trupanea femoralis</i> (Thomson) [TRUPFE] 79.70 <i>Trupanea wheeleri</i> (Curran) [TRUPWH] 79.71 <i>Trypanocentra nigrithorax</i> Malloch [TRYNNI] 79.72 <i>Trypeta flaveola</i> Coquillett [TRYEFL] 79.73 <i>Urophora christophi</i> Loew [URORCH] 79.74 <i>Xanthaciura insecta</i> (Loew) [XANRIN] 79.75 <i>Zacerata asparagi</i> Coquillett [ZACEAS] 79.76 <i>Zengodacus</i> spp. [1ZEUDG] 79.77 <i>Zonosemata electa</i> (Say) [ZONOEL]
80.	<i>Thaumatotibia leucotreta</i> (Meyrick) [ARGPLE]
81.	<i>Toxoptera citricida</i> (Kirkaldy) [TOXOCI]
82.	<i>Trioxa erytrae</i> Del Guercio [TRIZER]
83.	<i>Trirachys sartus</i> Solsky [AELSSA]
84.	<i>Unaspis citri</i> (Comstock) [UNASCI]
4. Molusqet	
1.	<i>Pomacea</i> (Perry) [1POMAG]



5. Nematodat	
1.	<i>Bursaphelenchus xylophilus</i> (Steiner dhe Bühner) Nickle <i>et al.</i> [BURSXY]
2.	<i>Globodera pallida</i> (Stone) Behrens [HETDPA]
3.	<i>Globodera rostochiensis</i> (Wollenweber) Behrens [HETDRO]
4.	<i>Hirschmanniella</i> spp. Luc & Goodey [HIRSG], përveç: <i>Hirschmanniella behningi</i> (Micoletzky) Luc & Goodey [HIRSBE], <i>Hirschmanniella gracilis</i> (de Man) Luc & Goodey [HIRSGR], <i>Hirschmanniella halophila</i> Sturhan & Hall, <i>Hirschmanniella loofi</i> Sher [HIRSLO] dhe <i>Hirschmanniella zostericola</i> (Allgén) Luc & Goodey [HIRSZO]
5.	<i>Longidorus diadecturus</i> Eveleigh dhe Allen [LONGDI]
6.	<i>Meloidogyne enterolobii</i> Yang & Eisenback [MELGMY]
7.	<i>Meloidogyne chitwoodi</i> Golden <i>et al.</i> [MELGCH]
8.	<i>Meloidogyne fallax</i> Karssen [MELGFA]
9.	<i>Nacobbus aberrans</i> (Thorne) Thorne dhe Allen [NACABA]
10.	<i>Xiphinema americanum</i> Cobb <i>sensu stricto</i> [XIPHAA]
11.	<i>Xiphinema bricolense</i> Ebsary, Vrain & Graham [XIPHBC]
12.	<i>Xiphinema californicum</i> Lamberti & Bleve-Zacheo [XIPHCA]
13.	<i>Xiphinema inaequale</i> Khan et Ahmad [XIPHNA]
14.	<i>Xiphinema intermedium</i> Lamberti & Bleve-Zacheo [XIPHIM]
15.	<i>Xiphinema rivesi</i> (popullata jo anëtare të BE-së) Dalmasso [XIPHRI]
16.	<i>Xiphinema tarjanense</i> Lamberti & Bleve-Zacheo [XIPHTA]
6. Bimë parazitare	
1.	<i>Arceuthobium</i> spp. [1AREG], përveç: <i>Arceuthobium azoricum</i> Wiens & Hawksworth [AREAZ], <i>Arceuthobium gambii</i> Fridl dhe <i>Arceuthobium oxycedri</i> DC.M. Bieb. [AREOX]
7. Viruset, viroidet dhe fitoplazmat	
1.	Beet curly top virus [BCTV00]
2.	Begomoviruses, përveç: Abutilon mosaic virus [ABMV00], Sweet potato leaf curl virus [SPLCV0], Tomato leaf curl New Delhi Virus [TOLCND], Tomato yellow leaf curl virus [TYLCV0], Tomato yellow leaf curl Sardinia virus [TYLCSV], Tomato yellow leaf curl Malaga virus [TYLCMA], Tomato yellow leaf curl Axarquia virus [TYLCAX]
3.	Black raspberry latent virus [TSVBL0]
4.	<i>Candidatus</i> Phytoplasma aurantifolia- shtami referues [PHYPAF]
5.	Chrysanthemum stem necrosis virus [CSNV00]
6.	Citrus leprosis viruset: 6.1. Citrus leprosis virus C [CILVC0] 6.2. Citrus leprosis virus C2 [CILVC2] 6.3. Hibiscus green spot virus 2 [HGSV20] 6.4. Citrus shtam of Orchid fleck virus [OFV00] (shtami citrus) 6.5. Citrus leprosis virus N sensu novo [CILVNO] 6.6. Citrus chlorotic spot virus [CICSV0]
7.	Citrus tristeza virus (izolime jo të BE-së) [CTV000]
8.	Coconut cadang-cadang viroid [CCCVD0]
9.	Cowpea mild mottle virus [CPMMV0]
10.	Lettuce infectious yellows virus [LIYV00]
11.	Melon yellowing-associated virus [MYAV00]
12.	Palm lethal yellowing phytoplasmas [PHYPS6]: 12.1. <i>Candidatus</i> Phytoplasma cocostanzania - subgroup 16SrIV-C 12.2. <i>Candidatus</i> Phytoplasma palmae - subgroups 16SrIV-A, 16SrIV-B, 16SrIV-D, 16SrIV-E, 16SrIV-F 12.3. <i>Candidatus</i> Phytoplasma palmicola - 16SrXXII-A 12.4. <i>Candidatus</i> Phytoplasma palmicola-shtam të lidhur 16SrXXII-B 12.5. <i>New Candidatus</i> Phytoplasma causing palm lethal yellowing from 16SrIV group - 'Bogio coconut syndrome'
12.1.	Rose rosette virus [RRV000]
13.	Satsuma dwarf virus [SDV000]
14.	Squash vein yellowing virus [SQVYVX]
15.	Tomato chocolate virus [TOCHV0]
16.	Tomato marchitez virus [TOANV0]
17.	Tomato mild mottle virus [TOMMOV]
18.	Viruses, viroids dhe phytoplasmas të <i>Cydonia</i> Mill., <i>Fragaria</i> L., <i>Malus</i> Mill., <i>Prunus</i> L., <i>Pyrus</i> L., <i>Ribes</i> L., <i>Rubus</i> L. dhe <i>Vitis</i> L.: 18.1 American plum line pattern virus [APLPV0]



	18.2 Apple fruit crinkle viroid [AFCVD0] 18.3 Apple necrotic mosaic virus 18.4 Buckland valley grapevine yellows phytoplasma [PHYP77] 18.5 Blueberry leaf mottle virus [BLMOV0] 18.6 Candidatus Phytoplasma aurantifolia-shtame të lidhur (Pear decline Taiwan II, Crotalaria witches' broom phytoplasma, Sweet potato little leaf phytoplasma [PHYP39]) 18.7 Candidatus Phytoplasma australiense Davis <i>et al.</i> [PHYPAU] (shtami referues) 18.8 Candidatus Phytoplasma fraxini (shtami referues) Griffiths <i>et al.</i> [PHYPPF] 18.9 Candidatus Phytoplasma hispanicum (shtami referues) Davis <i>et al.</i> [PHYPP7] 18.10 Candidatus Phytoplasma phoenicium [PHYPPH] 18.11 Candidatus Phytoplasma pruni-shtam të lidhur (North American grapevine yellows, NAGYIII) Davis <i>et al.</i> 18.12 Candidatus Phytoplasma pyri-shtam të lidhur (Peach yellow leaf roll) Norton <i>et al.</i> 18.13 Candidatus Phytoplasma ziziphi (shtami referues) Jung <i>et al.</i> [PHYPPZ] 18.14 Cherry rasp leaf virus (CRLV) [CRLV00] 18.15 Cherry rosette virus 18.16 Cherry rusty mottle associated virus [CRMAV0] 18.17 Cherry twisted leaf associated virus [CTLAV0] 18.18 Grapevine berry inner necrosis virus [GINV00] 18.19 Grapevine red blotch virus [GRBAV0] 18.20 Grapevine vein-clearing virus [GVCV00] 18.21 Peach mosaic virus [PCMV00] 18.22 Peach rosette mosaic virus [PRMV00] 18.23 Raspberry latent virus [RPLV00] 18.24 Raspberry leaf curl virus [RLCV00] 18.25 Strawberry chlorotic fleck-associated virus 18.26 Strawberry leaf curl virus 18.27 Strawberry necrotic shock virus [SNSV00] 18.28 Temperate fruit decay-associated virus
19.	Viruses, viroids dhe phytoplasmas of <i>Solanum tuberosum</i> L. dhe zhardhokët e tjerë <i>Solanum</i> spp.: 19.1 Andean potato latent virus [APLV00] 19.2 Andean potato mild mosaic virus [APMMV0] 19.3 Andean potato mottle virus [APMOV0] 19.4 Candidatus Phytoplasma americanum 19.5 Candidatus Phytoplasma aurantifolia-shtame të lidhur (GD32; St_JO_10, 14, 17; PPT-SA; Rus-343F; PPT-GTO29, -GTO30, -SINTV; Potato Huayao Survey 2; Potato hair sprouts) 19.6 Candidatus Phytoplasma fragariae-shtame të lidhur (YN-169, YN-10G) 19.7 Candidatus Phytoplasma pruni-shtame të lidhur (Clover yellow edge, Potato purple top Akpot7, MT117, Akpot6; PPT-COHP, -GTOP) 19.8 Chilli leaf curl virus [CHILCU] 19.9 Potato black ringspot virus [PBRV00] 19.10 Potato virus B [PVB000] 19.11 Potato virus H [PVH000] 19.12 Potato virus P [PVP000] 19.13 Potato virus T [PVT000] 19.14 Potato yellow dwarf virus [PYDV00] 19.15 Potato yellow mosaic virus [PYMV00] 19.16 Potato yellow vein virus [PYVV00] 19.17 Potato yellowing virus [PYV000] 19.18 Tomato mosaic Havana virus [THV000] 19.19 Tomato mottle Taino virus [TOMOTV] 19.20 Tomato severe rugose virus [TOSRV0] 19.21 Tomato yellow vein streak virus [TOYVSV] 19.22 Izolimet jo të BE-së të viruseve të patates S, X dhe Potato leafroll virus [PVS000], [PVX000] dhe [PLRV00]
20.	Grapevine flavescence dorée phytoplasma [PHYPP64]
21.	Tomato leaf curl New Delhi virus [TOLCND]



PJESA B
DËMTUESIT QË DIHET TË JENË HASUR NË TERRITORIN E REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË

Nr.	Dëmtuesit karantinorë dhe kodet e tyre të caktuara nga EPPO
1. Këpurdhat dhe oomicetet	
1.	<i>Entoleuca mamata</i> [HYPOMA]
2.	<i>Glomerella gossypii</i> [GLOMGO]
3.	<i>Gremmeniella abietina</i> [GREMAB]
2. Insektet dhe merimangat	
1.	<i>Anthonomus grandis</i> [ANTHGR]
2.	<i>Cephalcia lariciphila</i> [CEPCAL]
3.	<i>Daktulosphaira vitifoliae</i> [VITEVI]
4.	<i>Diaphorina citri</i> Kuwayana [DIAACI]
5.	<i>Dryocosmus kuriphilus</i> [DRYCKU]
6.	<i>Gilpinia bercyniae</i> (Hartig) [GILPPO]
7.	<i>Gonipterus scutellatus</i> speciet komplekse [GONPSC]
8.	<i>Helicoverpa zea</i> (Boddie) [HELIZE]
9.	<i>Liriomyza sativae</i> [LIRISA]
10.	<i>Rhagoletis pomonella</i> (Walsh) [RHAGPO];
11.	<i>Sternonchetus mangiferae</i> [CRYPMA]
12.	<i>Thaumetopoea pityocampa</i> [THAUPI]
13.	<i>Thrips palmi</i> Karny [THRIPL]
3. Viruset, viroidet dhe fitoplazmat	
1.	<i>Tomato Brown Rugose Fruit Virus</i> [TOBRFV]

URDHËR

Nr. 240, datë 9.3.2025

**PËR MARRJEN E MASAVE KUFIZUESE
PËR PARANDALIMIN DHE
KONTROLLIN E SËMUNDJES SË
INFLUENCËS AVIARE NË SHPENDË,
NË MJEDISËT E HAPURA DHE NË
TREGJET E KAFSHËVE TË GJALLA**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, të shkronjës “b”, të nenit 15, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

URDHËROJ:

1. Ndalimin e shitjes dhe tregtimit të shpendëve të gjallë në mjediset e hapura dhe tregjet e kafshëve të gjalla në territorin e:

- Njësisë Administrative Sukth;
- Njësisë Administrative Manëz;
- Njësisë Administrative Katund i Ri;
- Njësisë Administrative Maminas;
- Njësisë Administrative Gjepalaj;
- Njësisë Administrative Rashbull;
- Njësisë Administrative Thumanë;
- Njësisë Administrative Bubq;
- Njësisë Administrative Prezë;

- Njësisë Administrative Vorë.

2. Ndalimin e lëvizjes së shpendëve të gjallë nga ferma në fermë dhe nga ferma në tregjet e kafshëve të gjalla në territorin e:

- Njësisë Administrative Sukth;
- Njësisë Administrative Manëz;
- Njësisë Administrative Katund i Ri;
- Njësisë Administrative Maminas;
- Njësisë Administrative Gjepalaj;
- Njësisë Administrative Rashbull;
- Njësisë Administrative Thumanë;
- Njësisë Administrative Bubq;
- Njësisë Administrative Prezë;
- Njësisë Administrative Vorë.

3. Lejimin e lëvizjes së shpendëve të gjallë sipas tabelës 4, të shtojcës 5, të urdhrit nr. 177, datë 28.3.2023, “Për miratimin e Programit Kombëtar të Mbikëqyrjes së Influcencës Aviare”, vetëm me autorizim të veterinerit zyrtar për në thertore, pasi është kryer testi i PCR-së dhe shpendët kanë rezultuar negativ ndaj sëmundjes së influencës aviare dhe të jenë shoqëruar me certifikatën shëndetësore të lëvizjes së shpendëve, në territorin e:

- Njësisë Administrative Sukth;
- Njësisë Administrative Manëz;
- Njësisë Administrative Katund i Ri;
- Njësisë Administrative Maminas;
- Njësisë Administrative Gjepalaj;



- Njesisë Administrative Rashbull;
- Njesisë Administrative Thumanë;
- Njesisë Administrative Bubq;
- Njesisë Administrative Prezë;
- Njesisë Administrative Vorë.

4. Intensifikimin e mbikëqyrjes së popullatave të shpendëve të egër, veçanërisht ato të ujit, si dhe monitorimin e mëtejshëm për zogj të ngordhur ose të sëmurë në territorin e:

- Njesisë Administrative Sukth;
- Njesisë Administrative Manëz;
- Njesisë Administrative Katund i Ri;
- Njesisë Administrative Maminas;
- Njesisë Administrative Gjepalaj;
- Njesisë Administrative Rashbull;
- Njesisë Administrative Thumanë;
- Njesisë Administrative Bubq;
- Njesisë Administrative Prezë;
- Njesisë Administrative Vorë.

5. Ky urdhër zbatohet në përputhje me:

- Urdhrin nr. 117, datë 19.3.2022, “Për marrjen e masave kufizuese për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjes së influencës aviare në shpendë”;

- Urdhrin nr. 411, datë 20.9.2022, “Për miratimin e Planit të Kontigjencës për Sëmundjen e Influencës Aviare”;

- Urdhrin nr. 177, datë 28.3.2023, “Për miratimin e Programit Kombëtar të Mbikëqyrjes së Influencës Aviare”;

- Urdhrin nr. 235, datë 27.7.2009, “Për miratimin e rregullores ‘Mbi masat e biosigurisë ndaj gripit të shpendëve të shkaktuar nga nëntipi H5N1, në zogjtë e egër, në shpendët, pulat e stabilimenteve të shpendarisë’”;

- Urdhrin nr. 236, datë 27.7.2009, “Për miratimin e rregullores ‘Mbi disa masa mbi mbrojtjen ndaj gripit të pulave, shkaktuar nga nëntipi H5N1 tek zogjtë e egër’”.

6. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT SEKSIONI I TRETË

ÇËSHTJA GËLLÇI kundër SHQIPËRISË (Kërkesa nr. 15468/23)

VENDIM
STRASBURG
25 shkurt 2025

Ky është vendim përfundimtar, por mund t'i nënshtrohet rishikimit redaktorial.

Në çështjen Gëllçi kundër Shqipërisë,
Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
(Seksioni i Tretë), e mbledhur si Komiteti i përbërë nga:

Oddný Mjöll Arnardóttir, *President*,
Darian Pavli,
Diana Kovatcheva, *gjyqtarë*,
dhe Olga Chernishova, *zëvendëskancelare e Seksionit*,

Duke pasur parasysh:

kërkesën (nr. 15468/23) kundër Republikës së Shqipërisë të depozituar në Gjykatë sipas nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (“Konventa”), më 5 prill 2023, nga një shtetas i Shqipërisë dhe i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, z. Thoma Gëllçi (“kërkuesi”), i lindur në vitin 1961, me banim në Tiranë dhe i përfaqësuar nga z. D.Matlaja, avokat i licencuar në Tiranë;

vendimin për të njoftuar Qeverinë e Shqipërisë (“Qeveria”) të përfaqësuar nga z. O.Moçka, avokat i përgjithshëm i shtetit, për ankimet sipas nenit 5, paragrafi 3, të Konventës në lidhje me masën e sigurimit arrest në burg ndaj kërkuesit dhe për të shpallur të papranueshme pjesën tjetër të kërkesës; parashtrimet e palëve;

Pas diskutimit me dyer të mbyllura më 4 shkurt 2025,

mori vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua po në këtë datë:

OBJEKTI I ÇËSHTJES

1. Çështja ka të bëjë me ankimet sipas nenit 5, paragrafi 3, të Konventës, në lidhje me shkaqet e masës së sigurimit arrest në burg të vendosur ndaj kërkuesit. Kjo masë u urdhërua në kontekstin e procedimit penal kundër kërkuesit me akuzën e shpërdorimit të detyrës, për shkak të përfshirjes së dyshuar të tij si drejtor i Televizionit publik shqiptar



(*Televizioni shqiptar*) në lidhjen e kontratave të tenderimit publik për blerjen e pajisjeve teknike.

2. Në këtë procedim, me kërkesë të prokurorit, më 7 tetor 2021, Gjykata e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar urdhëroi masën e sigurimit arrest në burg ndaj kërkuesit. Gjykata e Shkallës së Parë u shpreh se kishte dyshim të arsyeshëm që kërkuesi kishte organizuar tenderin publik në fjalë pa marrë më përpara lejen nga Autoriteti Shqiptar i Medias, siç e kërkonte ligji. Ai u dyshua gjithashtu për shtyrje të afatit për zbatimin e kontratës edhe pse kjo mundësi nuk parashikohej me ligj. Kështu kërkuesi i kishte dhënë kohë shtesë palës fituese të kontratës duke vendosur në disavantazh ofertuesit e tjerë dhe shpërdoroi paratë publike, në kundërshtim me interesin publik.

3. Në lidhje me shkaqet e vendosjes së masës të sigurimit arrest në burg ndaj kërkuesit, gjykata e shkallës së parë u shpreh që prokuroria nuk i kishte mbledhur të gjitha provat dhe që kërkuesi, nëse do të hetohej në gjendje të lirë, mund të manipulonte provat dhe të ushtronte ndikim të dëshmitarët. Prokuroria kishte mbledhur prova shkresore, por disa dëshmitarë të mundshëm nuk kishin dhënë akoma deklaratimet e tyre. Gjithashtu gjykata u shpreh që kërkuesi kishte udhëtuar shpesh jashtë Shqipërisë dhe përbënte rrezik largimi në momentin që sapo ishte vënë në dijeni për akuzat kundër tij.

4. Kërkuesi u arrestua më 7 tetor 2021 dhe më 21 tetor 2021 ai doli përpara gjykatës së shkallës së parë. Ai parashittoi që ishte shkarkuar nga detyra pesë muaj më parë dhe prandaj nuk kishte mundësi të manipulonte të dhënat e dosjes së tenderit. Ai shtoi se dyshimet ndaj tij bazoheshin vetëm në dokumente që ishin sekuestruar më përpara nga prokuroria dhe prandaj nuk ekzistonte rreziku që ai të manipulonte ndonjë dëshmitar apo prova të tjera. Në lidhje me rrezikun e largimit, ai u shpreh që i ishte dorëzuar autoriteteve dhe konfiskimi i pasaportës së tij dhe/ose masa të tjera të sigurimit do të mjaftonin për të siguruar që ai të mos largohej nga vendi. Ai u shpreh që arresti i tij në burg nuk ishte proporcional duke pasur parasysh shëndetin dhe moshën e tij. Ai i kërkoi gjykatës të urdhëronte një masë sigurimi më të lehtë.

5. Në të njëjtën datë, gjykata e shkallës së parë konfirmoi masën e sigurimit arrest në burg ndaj kërkuesit, duke u shprehur që ndërkohë nuk kishin ndryshuar rrethanat për të cilat ishte urdhëruar

arresti në burg i kërkuesit, dhe që kjo masë sigurimi justifikohet akoma me rëndësinë e veprës penale dhe sanksionin e mundshëm.

6. Me anë të dy parashtrimeve të datës 28 dhe 29 tetor 2021, kërkuesi përsëriti argumentet e tij të mëparshme (shihni paragrafin 4 më sipër) përpara Gjykatës së Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Ai shtoi se që pas arrestit të tij në burg më 11 tetor 2021, prokurorët nuk kishin kryer ndonjë veprim hetimor, përfshirë marrjen e tij në pyetje. Gjithashtu ai u shpreh që prokurorët nuk kishin specifikuar se cila ishte prova që rrezikohet të manipulohet dhe nuk kishin shpjeguar arsyen pse kjo provë nuk ishte marrë në njëzet muajt e mëparshëm që nga fillimi i hetimit. Në lidhje me rrezikun e largimit, kërkuesi u shpreh që ai kishte qenë në Shtetet e Bashkuara gjatë muajve të mëparshëm të verës dhe ishte kthyer në Shqipëri edhe pse ishte në dijeni të hetimit kundër tij. Ai theksoi se një masë më pak shtrënguese ndaj tij do t'u përgjigjej rreziqeve mbi të cilat u bazuan prokurorët.

7. Më 30 tetor 2021, gjykata e apelit rrëzoi ankimin e kërkuesit dhe mbështeti arsyetimin dhe konkluzionet e vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Ajo u shpreh se kërkuesi i njihte viktimat e veprës penale të dyshuar, palën që ishte favorizuar pa të drejtë në tender dhe të dyshuarit e tjerë, prandaj ekzistonte risku që ata do të bëheshin bashkë dhe do të manipulonin provat. Sipas gjykatës, masa e sigurimit “ndalim i daljes jashtë shtetit” ose ndonjë masë tjetër më pak shtrënguese ishte e pamjaftueshme për të adresuar rreziqet në fjalë. Gjykata e Apelit shtoi se personaliteti i kërkuesit ishte “veçanërisht i rrezikshëm” meqë veprat penale kundër tij përfshinin shpërdorimin e detyrës dhe shpërdorimin e fondeve publike dhe dënoheshin me deri në shtatë vjet burg.

8. Kërkesat e mëtejshme të kërkuesit të 10 nëntorit 2021, 9 dhjetorit 2021, 9 shkurtit 2022 dhe 19 prillit 2022, që të hiqej masa e sigurimit arrest në burg ose të zëvendësohej me masa të tjera u rrëzuan nga gjykatat e brendshme me arsyetimin që nuk kishin ndryshuar kushtet mbi të cilat ishte vendosur masa e sigurimit arrest në burg.

9. Më 27 janar dhe 9 nëntor 2022, Gjykata e Lartë dhe Gjykata Kushtetuese, përkatësisht, rrëzuan ankimet e kërkuesve për shkaqet e pranueshmërisë. Vendimi përfundimtar iu dorëzua kërkuesit më 5 dhjetor 2022.



10. Më 2 qershor 2022, gjykata e shkallës së parë shpalli kërkuesin fajtor për akuzat kundër tij dhe e dënoi me një vit dhe katër muaj burg.

11. Më 30 gusht 2022, me kërkesë të kërkuesit, gjykata e shkallës së parë hoqi masën e ndalimit ndaj tij dhe urdhëroi lirimin e menjëhershëm.

VLERËSIMI I GJYKATËS

SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 5 § 3 TË KONVENTËS

12. Kërkuesi u ankua sipas nenit 5 paragrafit 1 (c) dhe paragrafit 3 të Konventës që nuk kishte shkak të vlefshëm për vendosjen e tij në arrest në burg dhe që kohëzgjatja e arrestit të tij në burg kishte qenë e tepruar.

13. Gjykata, si përgjegjëse për cilësimin që duhet t'i jepet në ligj fakteve të çështjes, vlerëson se ky ankim duhet të shqyrtohet vetëm sipas nenit 5 paragrafi 3 të Konventës (shihni për shembull, *Margaretić kundër Kroacisë*, nr. 16115/13, § 75, 5 qershor 2014).

A. Pranueshmëria

14. Qeveria u shpreh se kërkuesi kishte humbur statusin e palës së dëmtuar sepse që në momentin që kishte paraqitur kërkesën e tij në Gjykatë, masa e sigurimit ishte hequr tashmë.

15. Kërkuesi u shpreh që gjykata e brendshme nuk e kishte pranuar shkeljen e të drejtës së tij për liri personale.

16. Gjykata vëren që kërkuesi kaloi më shumë se shtatë muaj në paraburgim, dhe që vetë fakti që kjo periudhë kishte mbaruar përpara dorëzimit të kërkesës së tij në Gjykatë nuk mund t'i heqë statusin e palës së dëmtuar të shkeljes së pretenduar të nenit 5 të Konventës.

17. Gjykata më tej vëren se ky ankim nuk është haptazi i pabazuar sipas kuptimit të nenit 35 § 3 (a) të Konventës ose i papranueshëm bazuar në ndonjë shkak tjetër. Prandaj, ai duhet të shpallet i pranueshëm.

B. Themeli

18. Legjislacioni i brendshëm përkatës është paraqitur në *Delijorgji kundër Shqipërisë*, nr. 6858/11, §§ 39-50, 28 prill 2015, dhe *Hysa kundër Shqipërisë*, nr. 52048/16, §§ 26-41, 21 shkurt 2023.

19. Gjykata thekson që vazhdimësia e një dyshimi të arsyeshëm është kusht *sine qua non* për vlefshmërinë e arrestit në burg, por nuk mjafton më pasi kalon një farë kohe. Në këtë çështje, Gjykata duhet të verifikojë nëse shkaqe të tjera të dhëna nga autoritetet gjyqësore vazhdojnë të justifikojnë

heqjen e lirisë. Nëse këto shkaqe janë “relevante” dhe “të mjaftueshme”, Gjykata gjithashtu duhet të sigurohet nëse autoritetet kompetente kombëtare kanë treguar “kujdesin e veçantë” në zhvillimin e procesit (shihni *Buzadji kundër Republikës së Moldavisë* [DHM], nr. 23755/07, §§ 84-91, 102, GJEDNJ 2016, dhe *Merabishvili kundër Gjeorgjisë* [DHM], nr. 72508/13, §§ 222-25, 28 nëntor 2017).

20. Për t'u kthyer te çështja në fjalë, Gjykata vëren që vendosja e kërkuesit në paraburgim për qëllimet e nenit 5 § 3 të Konventës filloi më 8 tetor 2021 dhe përfundoi me dënimin e tij më 2 qershor 2022. Në këtë rast ai zgjati shtatë muaj dhe njëzet e gjashtë ditë.

21. Gjykata është e bindur se gjykatat e brendshme, bazuar në provat në dispozicion, provuan që ekzistonte dyshimi i arsyeshëm që kërkuesi kishte kryer veprën penale të shpërdorimit të detyrës së tij zyrtare.

22. Në lidhje me shkaqet për ndalimin e kërkuesit, gjykatat e brendshme u bazuan kryesisht në rrezikun që kërkuesi mund të manipulonte provat dhe të bashkëpunonte me dëshmitarët dhe në rrezikun e largimit.

23. Gjykatat e brendshme ju referuan nevojës për të marrë prova shtesë si shkak për zgjatjen e ndalimit të kërkuesit, pa bërë ndonjë përpjekje të mëtijshme për të treguar se si zbatohet specifikisht për çështjen e kërkuesit dhe zhvillimet e saj. Ato nuk specifikuan provat specifike që duhej të mblidheshin akoma si edhe nuk shpjeguan pse ato prova nuk mund të merreshin në një fazë më të hershme të hetimit. Ato nuk ju përgjigjën parashtrimeve të kërkuesit që dyshimi kundër tij bazohet në mënyrë ekskluzive mbi dokumente të cilat tashmë ishin sekuestruar nga prokuroria dhe që prandaj nuk ekzistonte rreziku që ai të manipulonte dëshmitarët apo provat e tjera (shihni paragrafin 4 më lart). Gjithashtu gjykatat e brendshme, në terma të përgjithshme, ju referuan rrezikut që, nëse do të lirohej, kërkuesi mund të manipulonte provat, dhe të kërcënonte dëshmitarët (krahasoni *Trzaska kundër Polonisë*, nr. 25792/94, § 65, 11 qershor 2000; *Hristov kundër Bullgarisë*, nr. 35436/97, § 105, 31 korrik 2003; *Belchev kundër Bullgarisë*, nr. 39270/98, § 79, 8 prill 2004; dhe *Eldar Hasanov kundër Azerbajxhani t*, nr. 12058/21, § 135, 10 tetor 2024). Nuk mund të pranohet parashtrimi i Qeverisë që kërkuesi njihej me personat të cilëve do u merrej deklarimi, në mungesë të provave faktike konkrete mbështetëse ose të ndonjë indicieje për



tentativën aktuale të kërkesit për t'u përfshirë në manipulimin e provave.

24. Në lidhje me rrezikun e largimit, Gjykata vëren se argumentet e kërkesit që ai kishte qenë jashtë dhe ishte kthyer me vullnetin e tij në Shqipëri në muajt paraprirës, dhe që ai i ishte dorëzuar vetë autoriteteve, pasi ishte vënë në dijeni të urdhrit të ndalimit ndaj tij, nuk janë peshuar siç duhet, gjithashtu duke pasur parasysh faktorët që lidhen me karakterin e personit, moralin e tij, familjen, profesionin, pasuritë, lidhjet familjare dhe lidhje të tjera me Shqipërinë (krahasoni *Buzadji*, cituar më lart, §§ 90 dhe 118). Gjykata më tej thekson se arsyetimi i gjykatave të brendshme nuk u shtjellua për të reflektuar situatën në zhvillim dhe për të verifikuar nëse ato shkaqe vazhdonin të ishin të mjaftueshme në fazën e avancuar të procesit penal.

25. Nuk duket as që ato gjykata kanë vlerësuar siç duhet ndonjë masë sigurimi alternative përtej një deklarate thjesht formale, dhe pavarësisht kërkesave të shumta të kërkesit për këtë qëllim.

26. Duke pasur parasysh praktikën e saj gjyqësore për temën dhe vlerësimet e mësipërme, Gjykata konkludon se shkaqet e dhëna nga autoritetet e brendshme nuk ishin të “mjaftueshme” për të justifikuar mbajtjen e kërkesit në paraburgim për periudhën përkatëse prej shtatë muajsh dhe njëzet e gjashtë ditësh nga 8 tetori 2021 deri më 2 qershor 2022.

27. Në këto rrethana, nuk është e nevojshme të shqyrtohet nëse proceset janë kryer me kujdesin e veçantë.

28. Prandaj në këto rrethana konstatohet shkelje e paragrafit 3, të nenit 5 të Konventës.

ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

29. Kërkuesi kërkoi 10,000 euro (EUR) për dëmin jopasuror, dhe 3,000 EUR për kosto dhe shpenzime të bëra para gjykatave të brendshme dhe 2,880 EUR për kosto dhe shpenzime të bëra para Gjykatës.

30. Qeveria e kundërshtoi pretendimin e kërkesit.

31. Gjykata i cakton kërkesit shumën prej 500 EUR për dëmin jopasuror, plus çdo taksë që mund t'i ngarkohet kërkesit.

32. Duke pasur parasysh dokumentet përpara saj, Gjykata e vlerëson të arsyeshme që të caktojë shpërblim 5,000 EUR që mbulon kostot nën të gjitha zërat, plus çdo taksë që mund t'i ngarkohet kërkesit, për t'u paguar në llogarinë bankare të përfaqësuesit të identifikuar prej tij (krahasoni

Carabulea kundër Rumanisë, nr. 45661/99, §§ 180 dhe 181, 13 korrik 2010).

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, UNANIMISHT,

1. *Shpall* kërkesën të pranueshme;
2. *Shprehet* që konstaton shkelje të nenit 5 § 3 të Konventës;

3. *Vendos*:

a) që Shteti i paditur t'i paguajë kërkesit, brenda tre muajve, shumat e mëposhtme, që do të konvertohen në monedhën e Shtetit të paditur me kursin e këmbimit në fuqi në datën e shlyerjes:

i. 500 euro (pesëqind euro) për dëmin jopasuror, plus çdo taksë që mund të ngarkohet;

ii. 5,000 (pesë mijë euro) EUR për kostot dhe shpenzimet, plus çdo taksë që mund t'i ngarkohet kërkesit që do të paguhet në llogarinë bankare të përfaqësuesit të caktuar prej tij;

b) nga mbarimi i afatit tre mujor të sipërpërmendur deri në shlyerje, interes i thjeshtë të paguhet për shumat e mësipërme sipas normës të njëjtë me normën marxhinale të kreditimit të Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së mospagimit plus tre pikë përqindje;

4. *Rrëzon* pjesën tjetër të pretendimit të kërkesit për kompensim të drejtë.

Bërë në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më 25 shkurt 2025 sipas Rregullit 77 §§ 2 dhe 3 të Rregullores së Gjykatës.

Olga Chernishova
Zëvendëskancelare në detyrë

Oddný Mjöll Arnardóttir
President

VENDIM Nr. 6, datë 10.2.2025

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare,



me sekretare Enina Kotoni, në datën 28.1.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare publike çështjen nr. 5 (Nj) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: JO MË PAK SE NJË E PESTA E DEPUTETËVE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, përfaqësuar nga deputete Ina Zhupa dhe avokat Franci Nuri, me autorizim.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, përfaqësuar nga Gazmend Bici, me autorizim.

AKADEMIA E SHKENCave, përfaqësuar Alma Bela, me autorizim.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i ligjit nr. 69/2023, datë 21.7.2023, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 53/2019, datë 18.7.2019 ‘Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë’”, si i papajtuashëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, pika 1, 6, 7, 15, 18, 81, 82, 83, 124, 131, pika 1, shkronjat “a” dhe “e”, 134, pika 1, shkronja “c” dhe 135 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); ligji nr. 53/2019, datë 18.7.2019, “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Sonila Bejtja, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuarit, jo më pak se një të pestës së deputetëve (*kërkuar*), i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjekteve të interesuara, Kuvendit të Republikës së Shqipërisë (*Kuvendi*) dhe të Akademisë së Shkencave (*Akademia*), që kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, konstatoi mungesën e parashtrimeve me shkrim të Presidentit të Republikës së Shqipërisë (*Presidenti*), si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Në datën 18.7.2019, Kuvendi ka miratuar ligjin nr. 53/2019, “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë” (*ligji nr. 53/2019*), qëllimi dhe objekti i të cilit kanë qenë përcaktimi i kuadrit ligjor për organizimin dhe funksionimin e

Akademisë, përcaktimi i rolit, i organeve përbërëse dhe i atyre që veprojnë pranë saj, si dhe rregullimi i marrëdhënieve me institucionet e tjera të kërkitit shkencor e të politikave të zhvillimit.

2. Në datën 20.7.2023, Kuvendi ka miratuar ligjin nr. 69/2023, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 53/2019, datë 18.7.2019 ‘Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë’” (*ligji nr. 69/2023*). Presidenti e ka kaluar në heshtje, pa dekret, për rrjedhojë ligji është shpallur me kalimin e afatit 20-ditor, bazuar në pikat 1 dhe 2 të nenit 84 të Kushtetutës dhe ka hyrë në fuqi në datën 6.9.2023, pra 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare nr. 124, datë 21.8.2023. Nga përmbajtja e relacionit shoqërues rezulton se qëllimi ka qenë korrigjimi i bazave juridike të ligjit nr. 53/2019 për organizimin dhe funksionimin e Akademisë. Objektivat e tij kanë qenë të lidhura me përbërjen dhe detyrat e Asamblesë, me zgjedhjen e kryesisë, me vlefshmërinë dhe ndërprerjen e mandateve, si dhe me administratën e Akademisë. Me ligjin nr. 69/2023 u riformuluan dhe shfuqizuan dispozitat si vijojnë:

3. U riformulua pika 3, e nenit 6: “*Asambleja zgjedh edhe anëtarë të jashtëm ndër personat me shtetësi apo origjinë shqiptare me banim jashtë vendit, figura të shkencës e të kulturës, si dhe anëtarë nderi ndër figurat e shkencës e të kulturës që janë shtetas jo shqiptarë me banim jashtë vendit, të cilët me punimet e tyre kanë ndikuar në ecurinë e mendimit e të zbatimit të shkencës në Shqipëri apo në promovimin e të vërtetave dhe të vlerave të origjinës, gjuhës e kulturës shqiptare. Numri i anëtarëve të nderit është deri në 15. Personat me origjinë shqiptare, që janë anëtarë me të drejta të plota të një akademie pjesëtare të “All European Academies”, fitojnë drejtpërdrejt statusin e anëtarit të jashtëm të Akademisë së Shkencave, e cila formalizohet nga një mbledhje ceremoniale e Asamblesë”.*

4. U riformulua neni 10: “*Anëtarët e jashtëm dhe ata të nderit kanë të drejtë të marrin pjesë në mbledhjet e Asamblesë pa të drejtë vote, si dhe në të gjitha aktivitetet e Akademisë. Me pëlqimin e tyre, ata aktivizohen dhe kontribuojnë në plotësimin e detyrave të Akademisë dhe të anëtarëve të saj, të parashikuara në nenet 4 dhe 9 të këtij ligji”.*

5. U riformulua pika 3, e nenit 11: “*Kryetari i Akademisë së Shkencave dhe anëtarët e Kryesisë zgjidhen nga Asambleja me votim të fshehtë dhe të drejtpërdrejtë me shumicën absolute të votave të vlefshme të anëtarëve të Asamblesë”.*



6. U riformulua pika 4, e nenit 11: “*Mandati i kryetarit dhe i zëvendëskryetarit është 4 vjet, ndërsa ai i sekretarit shkencor dhe i drejtuesve të seksioneve është 5 vjet. Kryetari, zëvendëskryetari, sekretari shkencor dhe drejtuesit e seksioneve mund të rizgjidhen në të njëjtin funksion për dy mandate*”.

7. U shfuqizuan pikat 9 dhe 10, të nenit 11, në pikën 4, të nenit 14, fjala “korrespondent” është zëvendësuar me fjalën “i jashtëm” dhe u shfuqizua shkronja “c”, pika 2, e nenit 16 të ligjit nr. 53/2019 (sipas së cilës mbushja e moshës 75 vjeç ishte shkak për ndërprerjen e mandatit të anëtarit të Asamblesë).

8. Në datën 10.5.2024, kërkuksi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me kërkesë për shfuqizimin e ligjit nr. 69/2023, i cili ka riformuluar dhe ka ndryshuar disa dispozita të ligjit nr. 53/2019, si të papajtueshme me Kushtetutën. Kolegji i Gjykatës në datën 10.6.2024 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare publike.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

9. **Kërkuksi**, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar:

9.1 Për procedurat parlamentare

9.1.1 *Procedura e miratimit të ligjit nr. 69/2023 cenon nenin 78, pika 2, të Kushtetutës*, pasi mbledhja e Komisionit Parlamentar për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik (*Komisioni i Edukimit*) është mbajtur në shkelje të Rregullores së Kuvendit. Më konkretisht, projektligji është futur në kalendarin e punës së Kuvendit për periudhën 22 maj-30 qershor dhe është marrë në shqyrtim në datën 11 korrik 2023. Mbledhja e Komisionit të Edukimit është zhvilluar me anëtarët zëvendësues të komisionit, në shkelje të nenit 21/1, pika 2, të Rregullores së Kuvendit. Kryetarja e komisionit nuk e ka thirrur mbledhjen dhe një e katërta e anëtarëve nuk mund ta thërriste atë pa depozituar kërkesën zyrtare në protokoll, ku të vërtetoheshin firmat e kërkuësve, duke u cenuar pika 2 e nenit 32 të Rregullores Kuvendit. Gjithashtu, programi i punës dhe kalendar i komisionit nuk ishin përgatitur nga kryetari i komisionit sipas nenit 33 të Rregullores së Kuvendit. Projektligji i paraqitur për miratim në komision nuk ka qenë i shoqëruar me raportin final, sipas nenit 38, pika 5/1, të Rregullores së Kuvendit dhe hartimi e miratimi i tij kanë shkelur nenet 68, pika 2 dhe 70, pikat 3 dhe 4, të Rregullores së

Kuvendit, pasi nuk përmbante objektivat që synoheshin të arriheshin, si dhe raportin e hartuar nga komisioni përgjegjës për seancën plenare. Nga pikëpamja formale pretendohet se ligji e ka zanafillën pas vendimit nr. 50 të vitit 2022 të Asamblesë, por ky vendim është vetëm një dokument i brendshëm, pa vlerë juridike, i cili nuk tregon aspak që Akademia të ketë diskutuar, analizuar ose ngritur grup pune për nevojën e ndryshimeve ligjore.

9.2 Për themelin. *Dispozitat e kundërshtuara të ligjit nr. 69/2023 cenojnë:*

9.2.1 *Parimet e shtetit të së drejtës, të barazisë përpara ligjit, të konfliktit të interesave, si dhe atë të hierarkisë së normave*, pasi ligji duhet të jetë i përgjithshëm dhe në funksion të interesit të shoqërisë dhe jo të një individi të paracaktuar ose të caktueshëm lehtësisht. Nuk mund të konsiderohet ligj një normë, e cila nuk synon rregullimin e situatave të përgjithshme dhe nuk mbart karakter universal, të mbështetur në interesin e përgjithshëm publik që në realitet është shtrembërim i kushteve dhe kriterëve të ligjit në funksion ose në shërbim të një individi. Kryetari i Akademisë gjatë kohës që shqyrtohej ligji nuk i plotësonte kushtet ligjore për të kandiduar sepse sipas ligjit nr. 53/2019 nuk lejohej të kandidonte për dy mandate radhazi, si dhe plotësimi i moshës mbi 75 vjeç përbënte shkak për ndërprerjen e mandatit të anëtarit të Asamblesë. Me ndryshimet e fundit ligjore ai i plotëson kriteret e reja, pasi të dyja këto kushte janë shfuqizuar. Sipas ligjit nr. 69/2023, askush nga akademikët nuk mund të ketë të drejta dhe detyra si akademik ose akademik i asociuar pas moshës 75 vjeç përveç kryetarit. Ky është një nonsens juridik që nuk mund të ndodhë në një shtet të së drejtës, pasi: ose të gjithë akademikët mbi 75 vjeç do të vazhdojnë të jenë anëtarë të asamblesë, të ushtrojnë të drejta dhe detyra si më parë; ose asnjëri nga ata, sepse *cenohet neni 18 i Kushtetutës, barazia përpara ligjit*. Ligji trajton ndryshe situata të njëjta, krijon diskriminim dhe pabarazi midis anëtarëve të Akademisë, me qëllim favorizimin e kryetarit aktual të institucionit, duke i hapur rrugë rizgjedhjes së tij. Edhe vetë heqja e togfjalëshit “*por jo radhazi*”, i parashikuar në ligjin nr. 53/2019, duke i hapur rrugë rizgjedhjes së kryetarit për një mandat të dytë, cenon parimin e barazisë përpara ligjit. Vetë nismëtarët e ligjit janë ata që përfitojnë nga ndryshimet ligjore, duke dëshmuar se *ligji krijon konflikt interesi dhe është në shkelje të Kushtetutës*. Të gjitha këto pretendime duhet



të shqyrtohen në këndvështrimin e respektimit të parimit të shtetit të së drejtës, të sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës. Parimi i shtetit të së drejtës është trajtuar i lidhur ngushtë edhe me parimin e hierarkisë së akteve normative, duke e konsideruar këtë të fundit si detyrim që rrjedh nga parimi i shtetit të së drejtës dhe i koherencës në sistemin ligjor. Ligji nr. 53/2019, i ndryshuar me ligjin nr. 69/2023 duhet të garantojë parimin kushtetues të autonomisë dhe lirisë akademike, të parashikuar nga neni 57, pika 7, i Kushtetutës, sipas të cilit statusi i anëtarit të rregullt të Akademisë nuk është i barabartë në të drejta me kryetarin aktual, të cilit i jepen privilegje.

9.2.2 *Parimin e sigurisë juridike*, pasi ligji përmban dispozita që kundërshtojnë njëra-tjetrën dhe nuk ka qartësinë e nevojshme në zbatim. Nga njëra anë përcakton se personat mbi 75 vjeç fitojnë statusin e anëtarit “emeritus”, i cili u heq disa të drejta dhe detyrime, pasi nuk konsiderohen më pjesë e Asamblesë, por, nga ana tjetër, përjashtohet kryetari, i cili, edhe pse me mbushjen e moshës 75 vjeç, do të vijojë të ushtrojë këtë detyrë. Ligji në fuqi konsideron se faktori moshë, pa përjashtuar askënd, merret si parametri kryesor, sipas të cilit anëtari i Asamblesë kalon në një status tjetër, në anëtar “emeritus”, duke u përjashtuar nga detyrimi për të marrë pjesë aktivisht në mbledhjet e Asamblesë, të seksioneve, të komisioneve dhe nga e drejta për t’u zgjedhur në organet drejtuese. Nga njëra anë, ligji nuk e detyron anëtarin “emeritus” të marrë pjesë në veprimtarinë e Akademisë dhe, nga ana tjetër, kryetari (me statusin “emeritus”) do të vijojë të drejtojë dhe të organizojë punën e Akademisë. Për këto arsye ligji është kontradiktor dhe i pazbatueshëm.

10. **Subjekti i interesuar, Kuvendi**, ka prapësuar si vijon:

10.1 *Për procedurat parlamentare*

10.1.1 *Pretendimi është i pabazuar*, pasi projektligji i është nënshtruar shqyrtimit në dy komisione parlamentare, në Komisionin e Edukimit, në cilësinë e komisionit përgjegjës dhe në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut (*Komisioni i Ligjeve*), në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi. Gjatë shqyrtimit në Komisionin e Ligjeve nuk është ngritur asnjë pretendim për papajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën, si dhe në Komisionin e Edukimit gjatë seancës dëgjimore janë ftuar edhe anëtarët e Asamblesë. Në mbledhjen e Komisionit të

Edukimit ka qenë kuorumi i nevojshëm për të zhvilluar mbledhjen dhe për të marrë vendim. Projektligji është votuar nga numri i kërkuar i deputetëve sipas Rregullores së Kuvendit dhe, si i tillë, është plotësisht i ligjshëm. Për këtë arsye, pretendimi i kërkuar nuk ka bazë dhe nuk qëndron. Hartimi i projektligjit nga nismëtari nuk është bërë mbi bazën e një liste moshe me subjektet që aspirojnë për të kandiduar në organet drejtuese, por mbi bazën e një logjike e cila i hap rrugën zgjerimit dhe një përfshirjeje më të gjerë kandidatësh, të cilët sigurisht vendosin të kandidojnë me vullnetin e tyre të lirë. Nga ana tjetër, në transparencë të këtij procesi, komisioni parlamentar përgjegjës, gjatë shqyrtimit të projektligjit ka ftuar në dëgjuesë anëtarët e Asamblesë, për të marrë edhe opinionin e tyre për projektligjin. Projektligjin e ka kundërshtuar vetëm 1 nga 54 anëtarët e Asamblesë, gjë e cila konfirmon qartësisht mbështetjen masive të të gjithë trupës së Akademisë.

10.2 *Për themelin*

10.2.1 *Pretendimi se ligji cenon nenin 18 të Kushtetutës është i pabazuar*, pasi ndryshimet nuk bien ndesh me asnjë normë të Kushtetutës, ato kanë karakter thjesht dhe vetëm teknik. Kërkuesi nuk provon në asnjë pjesë të parashtrimeve që ligji nr. 69/2023 diskriminon personin/kandidatin për të garuar si kryetar për asnjë nga shkaqet e përcaktuara në Kushtetutë, siç janë: gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. Ligji nr. 69/2023 nuk shpall askënd fitues, por, përkundrazi, zgjeron rrethin e kandidatëve dhe fituesit shpallen me votat e anëtarëve të Asamblesë, me votim të fshehtë e shumicë absolute, sikurse përcakton neni 11, pika 3, i riformuluar nga ligji objekt shqyrtimi. Ligji nuk krijon pabarazi midis akademikëve mbi 75 vjeç, as mes tyre, as në raport me të tjerët, përkundrazi zgjeron të drejtat e tyre. I vetmi kufizim që ka mbetur pas amendimit është pengesa për të kandiduar në organet drejtuese pas moshës 75 vjeç. Ligji nr. 69/2023 ka hequr kufizimin për ndërprerjen e mandatit të anëtarit të Asamblesë në rast se mbush këtë moshë.

10.2.2 *Pretendimi se ligji cenon parimin e sigurisë juridike është i pabazuar*, pasi ligji është në përputhje me frymën kushtetuese dhe praktikën e konsoliduar ndërkombëtare, sepse e drejta për t’u zgjedhur për dy mandate, pa kushte, është e sanksionuar edhe në



legjislacionin e akademive të shkencave dhe institucionet e arsimit të lartë në Evropë. Ligji nr. 69/2023 është në përputhje me nenin 58 të Kushtetutës, i cili garanton se liria e kërkimit shkencor mbrohet me ligj dhe nuk bie ndesh me asnjë dispozitë të Kushtetutës, për rrjedhojë pretendimi është i pabazuar.

11. **Subjekti i interesuar, Akademia**, ka prapësuar si vijon:

11.1 *Për juridiksionin e Gjykatës*

11.1.1 Akademia nuk është institucion i parashikuar në Kushtetutë, por vetëm i përmendur nga Kushtetuta. Për më tepër, nëpërmjet kërkesës së paraqitur nga kërkuesi dhe në tërësi nga parashtrimet e faktet e pretenduara është arritur në përfundimin se, në thelb, Gjykatës i kërkohet të shqyrtojë legjitimitetin e rikandidimit e të zgjedhshmërisë së kryetarit të Akademisë. Pra, Gjykatës i kërkohet të shqyrtojë një çështje sipas nenit 131, pika 1, shkronja “c” dhe qëllimisht ngatërrohet me çështjen e shqyrtimit të pajtueshmërisë së ligjit me Kushtetutën.

11.2 *Për procedurat parlamentare*

11.2.1 *Pretendimi është i pabazuar*, pasi ligji, si projekt fillestar, është ideuar, kërkuar e mbështetur nga Asambleja me të drejtën që gëzon një institucion autonom për organizimin e vet. Ky vendim është miratuar me shumicën e anëtarëve të Asamblesë dhe me vetëm një abstenim. Pra, ligji nuk krijon pabarazi midis anëtarëve, nuk cenon parimin e sigurisë juridike dhe autonominë e institucionit. Çdo “akuzë” për kapje institucionale ose cenim të sigurisë juridike nuk qëndron, pasi një institucion kolegial autonom nuk ndodh të kapë vetveten, të shkelë të drejtat e veta ose edhe të një anëtarit të vetëm me anë të ligjit për organizimin e funksionimit të tij. Procedura që është ndjekur për miratimin e ndryshimeve objekt të këtij gjykimi, është e njëjta procedurë që është ndjekur edhe për hartimin e miratimin e ligjit nr. 53/2019. Shtatë vjet më parë Akademia është kërkuar ta bëjë vetë reformimin e saj, në respektim të statusit si institucion autonom. Projektligji i ri është hartuar nga një grup pune i ngritur nga Asambleja, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për arsimin. Shumicën dërmuese dhe drejtimin e grupit e përbënin anëtarët e Akademisë. Pas hartimit e marrjes së pëlqimit për të edhe nga ALLEA (European Federation of Sciences and Humanities-grupimi i 60 akademive të vendeve të Bashkimit

Evropian), në respekt të autonomisë së Akademisë është vlerësuar që projektligji t'i kalojë drejtpërdrejt Kuvendit nëpërmjet nismës së deputetëve dhe jo të ekzekutivit (qeverisë). Deputeti relator i ligjit ka ndjekur në vazhdimësi veprimtarinë e Akademisë, për rrjedhojë është njohur paraprakisht për nevojën e këtyre ndryshimeve dhe ka marrë nismën për këto ndryshime së bashku me një koleg. Çdo procedurë është ndjekur dhe është kryer me dijeni të Asamblesë dhe në mënyrë transparente. Zbatimi i Rregullores së Kuvendit është një çështje e brendshme e Kuvendit. Paraqitja e një projektligji me 4–5 nene (saktësisht më 9.1.2023) dhe miratimi pas 6 muajve nuk përbën asnjë privilegj ose shkelje të afateve minimale për shqyrtimin e tij. Pas konfliktit publik-mediatik, ai ka vazhduar në Kuvend. Ndërkohë nismëtarët, në të drejtën e tyre, e kanë tërhequr amendamentin që lidhej me financat, pavarësisht që dukshëm projektligji nuk kishte efekte financiare. Në praktikën parlamentare nuk ka ndodhur që një komision të mos votojë për një projektligj pas shqyrtimit të tij. Gjatë shqyrtimit të projektligjit në Asamble e më pas në Kuvend, në Komisionin e Edukimit dhe, veçanërisht, në Komisionin e Ligjeve nuk është ngritur asnjë pretendim për mospërputhje të amendamenteve të propozuara me normën kushtetuese. Akademia, me vendimin nr. 50, datë 8.9.2022 të Asamblesë, ka shprehur miratimin e saj për ndryshimet në ligj.

11.3 *Për themelin*

11.3.1 *Pretendimi për cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit është i pabazuar*, pasi ndryshimet kryesore në ligj lidhen me: (i) heqjen e kufizimit të numrit të anëtarëve të jashtëm, sepse është hequr kufizimi deri në 10, duke riformuluar nenin 6, pika 3, të ligjit nr. 53/2019; (ii) rizgjedhjen për dy mandate të kryetarit, zëvendëskryetarit, sekretarit shkencor dhe drejtuesve të seksioneve, duke u hequr togfjalëshi “*por jo radhazi*”. Riformulimi nuk bie ndesh me asnjë normë të Kushtetutës. Ai është në përputhje të plotë edhe me frymën kushtetuese e praktikën e konsoliduar ndërkombëtare, pasi e drejta për t'u zgjedhur për dy mandate, pa kufizime, është e sanksionuar në legjislacionin e shumë akademive të shkencave dhe institucionet e arsimit të lartë në Evropë e Shqipëri. Kjo mundësi parashikohet shprehimisht në ligjin nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë”. Kushtëzimi që mandatet të mos ishin radhazi ishte i pazakontë, e për më tepër sipas



ligjit nr. 53/2019 jo vetëm nuk ndalohej rikandidimi, por bëhej i interpretueshëm për tre mandate. Ndryshimi për heqjen e kufizimit në numër për anëtarët e jashtëm u imponua nga nevoja e hapjes së mëtejshme të Akademisë ndaj diasporës shkencore, e cila është zgjeruar e mbart potenciale të mëdha shkencore. Ky ndryshim, ndër të tjera, ka mundësuar pranimin e 6 anëtarëve të rinj të jashtëm e do të mundësojë pranimin nga personalitete të shquara të shkencës në Diasporë. Përmbajtja e ligjit objekt gjykimi nuk krijon pabarazi midis akademikëve 75 vjeç, as midis tyre, as në raport me të tjerët, përkundrazi zgjeron të drejtat e tyre. Për detyrat e marra anëtarët “emeritus” mbajnë përgjegjësi si të gjithë anëtarët e tjerë Fjalë se “pjesëmarrja e tyre në mbledhje është sipas mundësisë” nuk është kufizim, siç është interpretuar nga kërkuesi, ajo ka vetëm kuptimin që një akademik “emeritus” nuk përballë me ndëshkime për mospjesëmarrje fizike në mbledhje sipas nenit 6, pika 2 të statutit. I vetmi kufizim që ka mbetur pas amendimit është pengesa për të kandiduar në organet drejtuese pas moshës 75 vjeç, por ndërkohë ligji i ri heq ndërprerjen e mandatit në rast se anëtari mbush këtë moshë, pasi u vlerësua e tepërt që të kishte dy kufizime moshore, si në marrjen e mandatit, ashtu edhe në mbylljen e tij përpara se të kishte përfunduar. Pra, ligji i zgjeron të drejtat e anëtarëve “emeritus” pa asnjë dallim dhe u kthen anëtarëve mbi 75 vjeç të drejtën e votës së anëtarësinë në Asamblë të hequr me ligjin e mëparshëm (2007), masë e vlerësuar kjo si antikushtetuese nga Gjykata me vendimin nr. 36, datë 15.10.2007, duke i bërë anëtarë të Asamblesë me të drejta e detyrime të plota. Ligji objekt gjykimi nuk shpall askënd fitues, ai lejon gjithkënd të kandidojë dhe të shpallet fitues me votat e anëtarëve të Asamblesë, me votim të fshehtë e shumicë absolute.

12. *Subjekti i interesuar, Presidenti*, nuk ka paraqitur parashtrime me shkrim, megjithëse është njoftuar rregullisht.

III

Procesi në gjykimin kushtetues

13. Kërkuesi në seancën plenare publike i ka parashtruar Gjykatës dy kërkesa paraprake: (i) vendosjen në dispozicion të vendimit për mosthirrjen e akademikut Artan Fuga, si subjekt i

interesuar; (ii) thirrjen e dy deputetëve të nismës ligjvënëse dhe të Presidentit, si dëshmitarë në gjykimin kushtetues.

14. Gjykata, pasi ka marrë në shqyrtim kërkesat paraprake, ka ritheksuar se bazuar në nenin 39, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000 dhe në jurisprudencën kushtetuese, përcaktimi i subjekteve të interesuara është në diskrecion të saj. Në këtë drejtim ajo nisat nga interesi që ka thirrja e tyre për të kontribuar në vendimmarrjen për çështjen që shqyrtohet. Vlerësimi i legjitimitetit të subjektit të interesuar bazohet jo vetëm në interesin e subjektit, por edhe të gjykimin kushtetues. Në këtë kuptim, në gjykimet kushtetuese legjitimohen si subjekte të interesuara ato që, për shkak të veprimtarisë ose rrethanave, mund të kontribuojnë në shqyrtimin e çështjes që po gjykohet, pavarësisht nëse thirren në gjykim me kërkesën e kërkuarit ose edhe kryesisht nga Gjykata (*shih vendimet nr. 37, datë 5.11.2021; nr. 9, datë 1.3.2021; nr. 9, datë 23.3.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Fillimisht, Gjykata thekson se identifikimi i subjekteve të interesuara është përcaktuar në nenin 26 pika 2 të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës e sipas këtyre parashikimeve, rrethi i këtyre subjekteve identifikohet nga Kolegji i Gjykatës, gjatë fazës së shqyrtimit paraprak të kërkesës. Në atë vendimmarrje të Kolegjit është vendosur kalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare publike duke u përcaktuar edhe rrethi i subjekteve të interesuara, siç ishin identifikuar edhe nga vetë kërkuesi në kërkesën e tij të datës 10.5.2024. Pavarësisht se ky i fundit, formalisht nuk e kishte kërkuar përfshirjen e akademikut Artan Fuga në cilësinë e subjektit të interesuar, në brendësi të kërkesës së tij i ishte referuar përfshirjes së tij, si subjekt i interesuar. Megjithatë, Kolegji i Gjykatës gjatë shqyrtimit paraprak ka vendosur të mos e përfshijë akademikun Artan Fuga në rrethin e subjekteve të interesuara.

16. Në datën 13.6.2024, vendimi i Kolegjit të Gjykatës i marrë gjatë shqyrtimit paraprak i është njoftuar kërkuarit, duke e bërë me dije se qëndrimin e akademikut Artan Fuga mund ta bënte pjesë të parashtrimeve të tij.

17. Kërkuesi e ka përsëritur kërkesën për përfshirjen e akademikut Artan Fuga edhe në datën 19.6.2024. Në përgjigje të kësaj kërkesë, në datën 28.6.2024, nëpërmjet sekretarit të përgjithshëm të Gjykatës, i është kthyer përgjigje kërkuarit sërish për vlerësimin e sipërcituar të Kolegjit gjatë shqyrtimit



paraprak, ku theksohet se Kolegji nuk kishte vlerësuar të thërriste në cilësinë e subjektit të interesuar akademikun Artan Fuga.

18. Në datën 13.7.2024, kërkuesi ka kundërshtuar shkresën e datës 28.6.2024. Pas shqyrtimit të kësaj kërkesë, në datën 20.9.2024, atij i është përcjellë në rrugë administrative vlerësimi i trupës së gjyqtarëve të Gjykatës për mospranimin e kërkesës për thirrjen e subjektit të interesuar z. Artan Fuga.

19. Për kërkimin e parë për disponimin e vendimit për mospranimin e kërkesës për të thirrur si subjekt të interesuar akademikun Artan Fuga, Gjykata gjatë vlerësimit mbajti në konsideratë se ajo është vënë në lëvizje nga kërkuesi për kontrollin abstrakt të normës, për rrjedhojë çmoi se akademiku Artan Fuga në rastin konkret nuk është në rrethin e subjekteve të interesuara sipas nenit 39, pika 1 të ligjit nr. 8577/2000. Gjykata evidentoi se edhe vetë ai në një deklaratë ka theksuar se ka interes vetjak ndaj çështjes. Për kërkesën për vënien në dispozicion të vendimit të Kolegjit që ka përcaktuar rrethin e subjekteve të interesuara, nisur nga interesimi i kërkuetit, Gjykata vlerësoi për t'i vendosur në dispozicion, për efekt njohjeje, një kopje të procesverbalit të Kolegjit, ku bazuar në nenin e sipërcituar të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës janë përcaktuar subjektet e interesuara. Për shkresën e datës 13.6.2024 (*shih paragrafin 16 të vendimit*), iu bë me dije se ajo përgjigje administrative ishte një praktikë e shërbimeve ndihmëse të Gjykatës, sipas udhëzimit të dhënë nga Mbledhja e Gjyqtarëve, për të orientuar palët për mënyrën se si ata mund të përfshijnë informacione ose opinione në parashtrimet e tyre.

20. Në lidhje me kërkimin e dytë, Gjykata bazuar në nenin 41 të ligjit nr. 8577/2000 dhe referuar fakteve kushtetuese të çështjes, objekt të provuari në proces, vlerësoi se nuk është e domosdoshme thirrja e dy deputetëve nismëtarë dhe e Presidentit si dëshmitarë. Për rrjedhojë, Gjykata në përfundim vlerësoi rrëzimin e kërkesave paraprake të kërkuetit.

21. Gjithashtu, Gjykata në objektin e parashtrimeve të depozituara në sekretarinë gjyqësore në përfundim të seancës plenare publike konstatoi se kërkuesi ka kërkuar edhe pezullimin e zbatimit të ligjit nr. 69/2023 derisa Gjykata të shprehet me vendim përfundimtar. Gjykata vlerëson se në rrethanat kur ky kërkim nuk është parashtruar nga kërkuesi në kërkesën e paraqitur në datën 10.5.2024 dhe nuk është kërkuar as gjatë

seancës plenare publike, kërkesa për pezullimin e zbatimit të ligjit e paraqitur vetëm në objektin e parashtrimeve shtesë nuk mund të merret në shqyrtim.

IV

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për juridiksionin e Gjykatës

22. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me kërkesë për shqyrtimin e pajtueshmërisë së ligjit nr. 69/2023 me Kushtetutën, pasi cenon pikën 2 të nenit 78 të saj, si dhe parimet e shtetit të së drejtës, të barazisë përpara ligjit, të konfliktit të interesit, të hierarkisë së normave juridike dhe të sigurisë juridike.

23. Subjekti i interesuar, Akademia, për juridiksionin ka parashtruar se në thelb Gjykatës i është kërkuar të shqyrtojë legjitimitetin e rikandidimit dhe të zgjedhshmërisë së kryetarit, për më tepër që Akademia nuk është organ kushtetues. Pra, sipas subjektit të interesuar, Gjykatës i është kërkuar të shqyrtojë një çështje sipas nenit 131, pika 1, shkronja “c” dhe qëllimisht ngatërrohet me çështjen e shqyrtimit të pajtueshmërisë së ligjit me Kushtetutën. Gjatë seancës plenare publike, subjekti i interesuar ka parashtruar se i qëndronte argumentit se Gjykata ka në juridiksion vlerësimin e kushtetutshmërisë së ligjit.

24. Gjykata thekson se referuar përmbajtjes së nenit 131 të Kushtetutës, shkronja “a” vendos për pajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se ka në juridiksionin e saj kontrollin abstrakt të kushtetutshmërisë së ligjit nr. 69/2023 “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë” dhe se pretendimet e subjektit të interesuar, Akademisë, për mungesën e juridiksionit të Gjykatës, për shkak se nuk është organ kushtetues dhe referenca prej tij në nenin 131, pika 1, shkronja “c”, të Kushtetutës, janë të pabazuara.

B. Për legjitimitimin e kërkuetit

25. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Për sa i takon legjitimitimit të kërkuetit për vënien në lëvizje të Gjykatës për kontrollin abstrakt të normës ligjore, në jurisprudencën kushtetuese në mënyrë të vazhdueshme është vlerësuar se ky subjekt, i parashikuar në nenin 134, pika 1, shkronja “c”, të Kushtetutës dhe nenin 49, pika 1, të ligjit nr.



8577/2000, ka të drejtë të paraqesë kërkesë për arsye të një interesi publik, pa u kushtëzuar me një interes subjektiv konkret. Interesi i këtyre funksionarëve publikë për të mbrojtur sistemin normativ dhe parimet shtetformuese, si konstitucionalizmi, shteti i së drejtës, demokracia, dinjiteti njerëzor, barazia sociale etj., të shpalosura në Kushtetutë, nuk është i kushtëzuar (*shih vendimet nr. 18, datë 7.7.2022; nr. 55, datë 27.7.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, për legjitimitimin *ratione personae*, Gjykata vëren se ajo është vënë në lëvizje nga një grup prej 37 deputetësh të Kuvendit, të cilët përbëjnë subjektin kushtetues jo më pak se një e pesta e deputetëve të Kuvendit, për rrjedhojë kërkuesi legjitimohet si në aspektin formal, ashtu edhe substancial për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.

26. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, bazuar në përmbajtjen e nenit 50, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, pasi ligji nr. 69/2023 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 124, datë 21.8.2023 dhe ka hyrë në fuqi 15 ditë pas botimit, në datën 6.9.2023, kurse kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 10.5.2024, pra brenda afatit ligjor 2-vjeçar.

27. Për sa i përket legjitimitimit *ratione materiae*, Gjykata vëren se kërkuesi ka parashtruar argumentet e tij në dy drejtime: (i) për shkeljen e procedurës së miratimit të ligjit sipas nenit 78, pika 2, të Kushtetutës dhe Rregullores së Kuvendit; (ii) për cenimin e parimeve të shtetit të së drejtës, të barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit, konfliktit të interesit dhe të hierarkisë së normave, si dhe të sigurisë juridike.

28. Fillimisht, në drejtim të legjitimitimit *ratione materiae*, Gjykata konstaton se kërkuesi në seancën plenare publike ka parashtruar se gjatë shqyrtimit të pajtueshmërisë së ligjit nr. 69/2023 me Kushtetutën, Gjykata duhet të vlerësojë argumentin nëse deputetët nismëtarë dhe Presidenti kanë ushtruar kompetencat e tyre në përputhje me Kushtetutën, sipas shkronjës “e” të nenit 131 të Kushtetutës të cituar edhe në bazën ligjore të kërkesës. Gjithsesi, kërkuesi gjatë seancës plenare publike nuk i ka kërkuar Gjykatës, që të vendosë papajtueshmërinë në ushtrimin e funksionit të funksionarëve të sipërcituar dhe në përfundim e ka lënë në çmimin e saj për të vlerësuar nëse janë shkelur të gjitha nenet e vendosura si bazë ligjore në kërkesë.

29. Në vijim të sa më lart, Gjykata vlerëson se kërkimi për të vlerësuar çështjen duke mbajtur në konsideratë shkronjën “e” të nenit 131 të

Kushtetutës, që parashikon shqyrtimin e çështjeve që lidhen, mes të tjerave, edhe me zgjedhshmërinë e papajtueshmërinë në ushtrimin e funksioneve të Presidentit dhe deputetëve, është i pabazuar, pasi në rastin konkret nuk jemi përpara rasteve të parashikuara sipas dispozitës kushtetuese të cituar nga kërkuesi.

30. Gjithashtu, Gjykata vëren se kërkuesi ka ngritur pretendimin për cenimin e parimit të shtetit të së drejtës në drejtim të parimit të hierarkisë së normave juridike dhe të konfliktit të interesit. Gjykata vlerëson se për këtë pretendim kërkuesi nuk ka parashtruar argumente kushtetuese se si ky parim është cenuar në drejtim të hierarkisë së normave juridike dhe konfliktit të interesit, ndaj për këtë arsye ai nuk mund të merret në shqyrtim.

31. Për sa u përket pretendimeve të tjera të kërkuetit për cenimin e pikës 2 të nenit 78, të Kushtetutës dhe të parimeve të barazisë përpara ligjit e mosdiskriminimit, si dhe të sigurisë juridike, Gjykata vlerëson se hyjnë në juridiksionin kushtetues e në vijim do të vlerësohet bazueshmëria e tyre në themel.

C. Për themelin e pretendimeve

C.1 Për cenimin e nenit 78, pika 2 të Kushtetutës

32. Kërkuesi ka pretenduar se gjatë miratimit të ligjit është cenuar neni 78, pika 2, i Kushtetutës, si dhe neni 32, pika 2 i Rregullores së Kuvendit. Më konkretisht, sipas kërkuetit, në datën 19.7.2023, pas një mbledhjeje të thirrur jo sipas procedurës, duke mos u njoftuar të gjithë anëtarët e komisionit dhe pa praninë e kryetares së komisionit, u votua projektligji. Relacioni që shoqëronte projektligjin nuk jepte argumente konkrete me shpjegime për nenet ku ishte ndërhyrë, për përmirësimet që do të sillte ndryshimi dhe as shpjegim për keqkuptimet që mund të kishin lindur gjatë zbatimit të ligjit. Në çdo rast, pavarësisht nëse mbledhjen e komisionit e kërkon kryetari ose një e katërta e deputetëve, rendin e ditës e përgatit kryetari dhe në rastin konkret, kryetarja ka shprehur gatishmërinë për të zhvilluar mbledhjen pasi deputetët të sillnin kërkesën e protokolluar. Kërkesa për thirrjen e mbledhjes është depozituar ditën e mbledhjes, madje anëtarët e komisionit e kanë dorëzuar atë në protokoll disa orë pas zhvillimit të mbledhjes së komisionit.

33. Ndërsa subjekti i interesuar, Kuvendi ka prapësuar se projektligji i është nënshtruar shqyrtimit në dy komisione parlamentare. Gjatë shqyrtimit në Komisionin e Ligjeve nuk është



ngritur asnjë pretendim për papajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën, si dhe në Komisionin e Edukimit gjatë seancës dëgjimore janë ftuar edhe anëtarët e Asamblesë së Akademisë. Në Komisionin e Edukimit ka qenë kuorumi i nevojshëm për të zhvilluar mbledhjen dhe për të marrë vendim. Projektligji është votuar nga numri i kërkuar i deputetëve sipas Rregullores së Kuvendit dhe si i tillë është plotësisht i ligjshëm. Për të gjitha këto arsye, sipas subjektit të interesuar pretendimi është i pabazuar.

34. Subjekti i interesuar, Akademia, ka parashtruar se ligji, si projekt fillestar, është ideuar, kërkuar e mbështetur nga Asambleja e Akademisë, me vendimin nr. 50, datë 8.9.2022, me të drejtën që gëzon një institucion autonom për organizimin e vet. Procedura që është ndjekur për miratimin e ndryshimeve objekt i këtij gjykimi, është e njëjta procedure që ishte ndjekur edhe për hartimin e miratimin e ligjit nr. 53/2019. Zbatimi i Rregullores së Kuvendit është një çështje e brendshme e tij. Paraqitja e propozimit për projektligjin me 4-5 nene në Kuvend (saktësisht më 9.1.2023) dhe miratimi pas 6 muajsh nuk përbëjnë asnjë privilegj ose shkelje të afateve minimale për shqyrtim e tij. Gjatë shqyrtimit të projektligjit në Asamble e më pas në Kuvend, në Komisionin për Edukimin dhe veçanërisht në Komisionin e Ligjeve nuk është ngritur asnjë pretendim për mospërputhje të amendamenteve të propozuara me normën kushtetuese.

35. Gjykata vëren se në Kushtetutë, në kreun III, që rregullon organizimin dhe funksionimin e Kuvendit parashikohet se mbledhjet e Kuvendit realizohen në sesione (neni 74) dhe se Kuvendi diskuton çështjet në seancë plenare (mbledhje), që si rregull bëhet e hapur (neni 79) ose e mbyllur në raste të veçanta (pika 4 e nenit 73). Ndërsa në nenin 77 të Kushtetutës parashikohet: *“Kuvendi zgjedh nga gjiri i tij komisione të përbershme, si dhe mund të caktojë komisione të posaçme”*. Ndërsa në vijim, në pikën 2 të nenit 78 të Kushtetutës parashikohet: *“Mbledhjet e deputetëve që mbahen pa u thirrur sipas rregullores, nuk sjellin asnjë pasojë”*.

36. Bazuar në dispozitat e sipërcituara, Gjykata vëren se në Kushtetutë parashikohen disa forma të mbledhjes së Kuvendit dhe në pikën 2 të nenit 78 të Kushtetutës përdoret një koncept i përgjithshëm duke iu referuar “mbledhjet e deputetëve”, por nuk është specifikuar mënyra konkrete e realizimit të

tyre. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se parashikimi në pikën 2 të nenit 78 të Kushtetutës se “mbledhjet që mbahen pa u thirrur sipas rregullores nuk sjellin asnjë pasojë” nuk u referohet vetëm seancave plenare/mbledhjeve të deputetëve në Kuvend, por shtrihet edhe për procedurën e thirrjes së deputetëve në mbledhjet e komisioneve parlamentare të përhershme bazuar në Rregulloren e Kuvendit.

37. Duke mbajtur në konsideratë këtë vlerësim, Gjykata çmon se pika 2 e nenit 78 të Kushtetutës gjen pasqyrim në përmbajtjen e pikës 2 të nenit 32 të Rregullores së Kuvendit, që parashikon se mbledhjet e komisionit të përhershëm thirren nga: (i) kryetari i tij; (ii) jo më pak se një e katërta e anëtarëve të komisionit; (iii) kryetari i Kuvendit, duke përcaktuar në kërkesë dhe çështjet që do të diskutohen në mbledhje.

38. Në drejtim të respektimit të Rregullores së Kuvendit, Gjykata në jurisprudencën e saj, bazuar në parimin e autonomisë parlamentare, ka theksuar se mosrespektimi i Rregullores e bën veprimtarinë parlamentare antikushtetuese vetëm nëse janë prekur dispozitat të nivelit kushtetues që gjejnë pasqyrim në të, ndërsa për çështje të tjera Rregullorja nuk mund të jetë objekt kontrolli kushtetues (*shih vendimet nr. 54, datë 9.7.2024; nr. 48, datë 19.6.2024; nr. 35, datë 10.10.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

39. Për sa më lart, pas shqyrtimit të pretendimit për cenimin e pikës 2, të nenit 78 të Kushtetutës, në përfundim të diskutimeve, vlerësimet e gjyqtarëve u ndanë në dy qëndrime dhe Gjykata nuk arriti numrin e kërkuar të votave për vendimmarrje, sipas parashikimeve të nenit 133, pika 2, të Kushtetutës dhe nenit 72, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000.

40. Sipas njërit qëndrim u vlerësua se pretendimi i kërkuar për mosrespektimin e procedurës parlamentare gjatë miratimit të ligjit nr. 69/2023 është i bazuar ndaj kërkesa duhej të ishte pranuar për këtë shkak. Në aspektin e veprimtarisë parlamentare, e cila edhe pse udhëhiqet nga parimi i autonomisë dhe vetërregullimit për disa aspekte të organizimit të funksionimit të Kuvendit dhe organeve të tij, Kushtetuta ka parashikuar në mënyrë të shprehur ato shkelje që e bëjnë jokushtetuese këtë veprimtari duke parashikuar në pikën 2 të nenit 78 edhe pasojën në rastin e mbajtjes së mbledhjeve në rast se ato nuk thirren sipas Rregullores së Kuvendit. Në këtë aspekt, për sa kohë që pasoja është e parashikuar drejtpërdrejt nga Kushtetuta, e vetmja mënyrë e kontrollit të kësaj veprimtarie është



mënyra se si janë zbatuar në rastin konkret dispozitat e brendshme rregullatore të Kuvendit.

41. Referuar Rregullores së Kuvendit, mënyra e thirrjes së deputetëve për mbledhjen në komision nëpërmjet postës elektronike (*e-mail*) nuk rezulton të jetë e parashikuar në mënyrë të shprehur ose të nënkuptuar dhe as nuk mund të deduktohet nga përmbajtja e tyre. Procedura e vetme e zbatuar në praktikën parlamentare, për thirrjen e një mbledhjeje, që duhet të ndiqet për njoftimin e deputetëve, është ajo me shkresë të protokolluar e depozituar në një kohë të arsyeshme duke u krijuar mundësinë deputetëve për të marrë dijeni efektivisht dhe të njihen me materialet që do të shqyrtohen në atë mbledhje. Referuar edhe akteve të kësaj procedure, rezulton se kjo formë thirrje (njoftimi nëpërmjet *e-mail*-it) nuk është përdorur për të gjitha mbledhjet e këtij komisioni. Ndërkohë që për mbledhjen e parë të komisionit (datë 11.7.2023), nuk ka pasur referim nga kërkuesi dhe as kundërshtim për mënyrën e thirrjes së saj, çka nënkupton se ajo është zhvilluar në përputhje me praktikën parlamentare, mbledhja e radhës e datës 19.7.2023 është kërkuar nga dy deputetët nismëtarë (pra jo nga subjekti një e katërta e deputetëve të komisionit) dhe njoftimi është bërë nëpërmjet *e-mail*-it. Referuar Rregullores së kuvendit, kjo procedure shfaq devijime nga parashikimet procedurale, të aspektit kushtetues që lidhen si me subjektin e legjitimuar për thirrjen e mbledhjes, ashtu edhe formën e njoftimit të anëtarëve të Komisionit të Edukimit.

42. Referuar edhe qëndrimin të krytares së komisionit, ajo ka kërkuar shprehimisht ndjekjen e rrugës së zakonshme për zhvillimin e kësaj procedure, që është protokollimi i kërkesës sipas Rregullores së Kuvendit, si e vetmja mënyrë për të thirrur mbledhjen e deputetëve dhe për t'i dhënë legjitimitet kushtetues asaj. Për rrjedhojë kjo qasje e saj, përbën konfirmim të faktit se procedura e thirrjes/njoftimit të anëtarëve të komisionit përkatës, nuk ka qenë e rregullt sipas parashikimeve procedurale të Kuvendit. Në këtë aspekt, duke qenë përpara një parashikimi të tillë procedural që çon në një shkelje të nivelit kushtetues nuk ka ndonjë rëndësi në rastin konkret fakti nëse deputetët kanë marrë dijeni dhe janë njohur ose jo me *e-mail*-in e dërguar për thirrjen e mbledhjes, dhe as fakti që *post*

factum është depozituar në sekretari kërkesa e firmosur formalisht nga 5 deputetë (një e katërta e anëtarëve të komisionit), për sa kohë që shkelja e kësaj procedure, edhe pa u evidentuar ose provuar ndonjë pasojë e bën procedurën që në nisjen e saj, antikushtetuese sipas nenit 78, pika 2, të Kushtetutës.

43. Për këto arsye, për sa kohë që mbledhja e komisionit të edukimit nuk është thirrur sipas parashikimeve të nenit 78, pika 2, të Kushtetutës dhe nenit 32, pika 2, të Rregullores së Kuvendit, çka veson nga pikëpamja kushtetuese të gjithë procedurën e miratimit të ligjit nr. 69/2023 nuk është e nevojshme vijimi me shqyrtimin dhe vlerësimin e themelit të pretendimeve të kërkuesit për përmbajtjen e këtij ligji¹.

44. Kështu sipas qëndrimit tjetër, zgjidhja e çështjes ka të bëjë me interpretimin e konceptit kushtetues “thirrje e mbledhjes” e ndërlidhur me parashikimet relevante të Rregullores së Kuvendit, në kushtet kur neni 78 pika 2 i Kushtetutës parashikon se mbledhjet e deputetëve që mbahen pa u thirrur sipas rregullores nuk sjellin asnjë pasojë. Koncepti “thirrje e mbledhjes”, në rastin e komisioneve parlamentare, nuk duhet interpretuar në një mënyrë të ngushtë dhe literale që do të prekte thelbin e këtij parashikimi kushtetues i cili, e ngre respektimin e rregullave për thirrjen e mbledhjes në nivelin e një kushti *sine qua non* për vlefshmërinë e mbledhjeve të deputetëve qoftë në nivel komisioni, qoftë në nivel të seancës plenare. Parashikimi i nenit 78, pika 2 të Kushtetutës nuk duhet të kuptohet thjesht dhe vetëm si një rregullim me natyrë procedurale por si një premisë e rëndësishme për mirëfunksionimin e një organi kolegjal, me konfigurim politik siç është Kuvendi, me pasoja të drejtpërdrejta në cilësinë e parlamentarizmit në vend. Për këtë arsye, koncepti “thirrje e mbledhjes” përfshin të gjitha dispozitat e Rregullores së Kuvendit që lidhen me mënyrën e caktimit të mbledhjes së Komisionit, të krijimit të rendit të ditës dhe të njoftimit të kohës dhe vendit të mbajtjes së mbledhjes, të cilat parashikohen në nenet 32-33 të Rregullores së Kuvendit. Në këtë pikë, duhet evidentuar se mënyra e funksionimit të Kuvendit, përfshirë atë të komisioneve parlamentare, duhet të udhëhiqet nga bashkëpunimi i sinqertë apo parimi i

¹ Votoi për pranimin pjesërisht të kërkesës sipas këtij qëndrimi gjyqtarja Sonila Bejtja.



luajalitetit kushtetues, i cili ka të bëjë, në thelb, me respektin e ndërsjellë nga secili subjekt ndaj kompetencave të tjetrit, si dhe nënkupton krijimin e një raporti bashkëpunimi midis tyre. Ky parim përfshin edhe detyrimin për sjellje koherente dhe jokontradiktore, pra palët nuk duhet të kenë qëndrime zvarritëse, bllokuese, të paqarta ose të pajustificuara, në mënyrë që bashkëpunimi midis tyre të jetë mbi baza mirëbesimi dhe korrekte, si dhe të jenë të hapura për qasjet e ndryshme të palës tjetër, por gjithnjë duke respektuar kompetencat që i janë dhënë secilës palë (*shih vendimin nr. 26, datë 25.5.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

45. Sipas neneve 32–33 të Rregullores së Kuvendit, mbledhjet e komisionit të përhershëm thirren nga kryetari i tij. Ato mund të thirren edhe me kërkesën e jo më pak se një të katërtës së anëtarëve të komisionit ose me kërkesën e kryetarit të Kuvendit, duke përcaktuar në kërkesë dhe çështjet që do të diskutohen në mbledhje (neni 32, pika 2). Kryetari i komisionit përgatit rendin e ditës, organizon punën për zhvillimin e mbledhjeve të komisionit dhe kryeson mbledhjet e tij (neni 33).

46. Në rastin konkret, Komisioni i Edukimit, që përbëhet nga 19 anëtarë, është mbledhur dhe ka shqyrtuar projektligjin në fjalë në datën 11.7.2023, mbledhje për të cilën nuk ka pasur ndonjë kontestim. Në këtë mbledhje, projektligji nuk është miratuar për shkak të mungesës së dokumentacionit (marje e një mendimi me shkrim). Komisioni i Edukimit ka zhvilluar edhe dy mbledhje të tjera në datat 11.7.2023 dhe 17.7.2023, por projektligji për akademinë nuk ka qenë pjesë e rendit të ditës. Në datën 18.7.2023, në orët e pasdites, dy anëtarë të komisionit, që i përkisnin shumicës parlamentare, kanë dërguar në rrugë elektronike secili kërkesë për mbledhjen e komisionit në datën 19.7.2023, ora 11:00 për shqyrtimin e projektligjit për akademinë. Këtyre dy kërkesave u janë përgjigjur edhe tre deputetë të tjerë të shumicës parlamentare, që në thelb, kanë dhënë pëlqimin për mbledhjen e komisionit. Ndërsa kryetarja e komisionit, që i përkiste pakicës parlamentare, është përgjigjur duke kërkuar që kërkesa të protokollohej sipas Rregullores së Kuvendit dhe se pas protokollimit, do të veprohej sipas kësaj rregulloreje. Po ashtu, ka pasur edhe përgjigje deputetësh të pakicës

parlamentare që kërkonin kohë për t'u përgatitur për çështjen. Secila kërkesë është dërguar veçmas, por brenda të njëjtit zinxhir komunikimi, duke iu drejtuar të gjithë anëtarëve të komisionit. Mbledhja është zhvilluar në datën 19.7.2023, ora 11:00 dhe projektligji është miratuar në Komision, vetëm me pjesëmarrjen e deputetëve të shumicës parlamentare, ndërsa kërkesa është protokolluar e nënshkruar nga pesë deputetët në datën 19.7.2023, ora 14:36.

47. Duke i vlerësuar këto fakte nën dritën e standardeve kushtetuese, nxirret përfundimi se mbledhja e Komisionit të Edukimit, e zhvilluar në datën 19.7.2023, nuk është thirrur sipas Rregullores së Kuvendit. Kërkesa për mbledhjen e komisionit, në ndryshim nga praktika e mëparshme parlamentare për depozitimin e tyre, është dërguar në rrugë elektronike dhe vetëm pas mbledhjes *de facto* të komisionit është depozituar në zyrën e protokollit të Kuvendit. Ndonëse në parim, përdorimi i postës elektronike lehtëson mënyrën e komunikimit dhe *prima facie* duket se thirrja e mbledhjes është bërë nga një e katërta e anëtarëve të komisionit (pesë deputetë), në rastin konkret dërgimi i kërkesës në mënyrë të ndarë nga pesë anëtarë dhe pa iu referuar qartësisht një teksti të përbashkët që të tregonte kohën e mbledhjes dhe çështjen për diskutim vë në dyshim thirrjen e saj. Duke mbajtur në konsideratë rrethanat e çështjes, në veçanti faktin që bëhej fjalë për një nismë të shumicës parlamentare dhe mënyrën se si u procedua për thirrjen e mbledhjes, mosmarrja në konsideratë e kërkesës së kryetares së komisionit për depozitimin e njoftimit për mbledhjen në zyrën e protokollit, arrihet në konkluzionin se thirrja e mbledhjes, në substancë, nuk ka respektuar parimin e luajalitetit kushtetues dhe dispozitat e Rregullores së Kuvendit.

48. Për sa më lart, në kushtet kur mbledhja e Komisionit të Edukimit nuk është thirrur sipas parashikimeve të nenin 78, pika 2, të Kushtetutës dhe nenit 32, pika 2, të Rregullores së Kuvendit, ajo nuk ka sjellë asnjë pasojë, ndaj për këtë shkak ligji nr. 69/2023 duhej të shfuqizohej për mosrespektim të procedurës së miratimit të tij. Rrjedhimisht, vlerësimi i pretendimeve të tjera të kërkuarit është i panevojshëm².

² Votuan sipas këtij qëndrimi gjyqtarët Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Genti Ibrahim.



